



**“MUAJI I RAMAZANIT,
NË TË CILIN
ZBRITI KUR'ANI”**



AGJËRIMI DHE SHËNDETI




**RAMAZANI,
MUAJI I BAMIRËSISË**

Viti XV - Nr. 6 (172),
Qershor, 2017

Botim i Myftinisë Shkodër

UDHA ISLAME

*E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative*



Si të përfitojmë nga Ramazani?

Si ta shfrytëzojmë Ramazanin? Si të përfitojmë sa më shumë prej tij? Pyetje që i vijnë ndërmend gjithsecilit nga ne në fillim të muajit të Ramazanit. Nuk ka mëdyshje që kjo pyetje nuk kanë ndonjë formulë magjike për zgjidhjen e saj dhe nuk mjafton vetëm njohja e kësaj formule, por thelbi i zgjidhjes së saj është vullneti i fortë, besimi i palëkundur, nijeti i sinqertë për të përfituar prej Ramazanit, një planifikim i qartë dhe i mirëstudiuar dhe një zbatim i riqoroz i tij. ...



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

RAMAZANI, MUAJI I RIMËKËMBJES

“Kur hyn muaji i Ramazanit, hapen dyert e xhennetit, mbyllën dyert e xhehemit dhe lidhen shejtanët me zinxhirë”

Nga këtu, më lejoni të ftoj gjithsecilin prej jush, që ta konsiderojmë këtë muaj si një mundësi për të ripërtëritur besimin tonë, për të shfaqur pendimin tonë ndaj All-llahut, për të rishikuar ekuilibrat e të mirës dhe të keqes përreth nesh dhe në vetvete, për ta vendosur veten në një pozitë që vlen, jo në një cep a qosk, ku realisht ndodhet bashkësia e muslimanëve shqiptarë sot; të anashkaluar, të neglizhuar, të shkëlur në të drejtat e tyre, të paragjykuar e të vetënjencuar nga mosfunksionimi i mekanizmave të organizimit elitar në komunitet, nga mungesa e një ekuilibri në drejtimin dhe orientimin e dhuntive, me të cilat All-llahu na ka begatuar si individë e si shoqëri!

TË DASHUR E TË NDERUAR,

Të dashur dhe të nderuar motra dhe vëllezër muslimanë, është shumë e rëndësishme për ne, si bashkësi vlerash, besimi dhe dijeje, që për shekuj kemi ndërtuar dhe përhapur me mund dhe sakrificë paqen, harmoninë e besimit, tolerancën ndaj të tjerëve duke mos humbur respektin për veten, dijen e dobishme dhe edukimin e njeriut me atë që iu shpall racës sonë nga Zoti i gjithësisë, të kuptojmë dhe të përhapim me të madhe faktin se, Muaji i Madhërisë së Ramazanit, është një mundësi e përvitshme, që vjen në heshtje, për të lajmëruar botërisht se muslimanët bëhen gati të ripërtërijnë vetveten, marrëdhënien me besimin, me fenë, me të sotmen dhe të nesërmen, me njeriun dhe gjithësinë përreth!

Hadithi i shumëlexuar gjatë këtij Muaji të Madhërisë së Ramazanit, në të cilin Resulull-llahu (a.s) thotë: “Kur hyn muaji i Ramazanit, hapen dyert e xhennetit, mbyllën dyert e xhehemit dhe lidhen shejtanët me zinxhirë”¹, është pa dyshim, pikënisja kryesore drejt leximit drejtë të mirësive dhe madhështisë së këtij Muaji, agjërimin e të cilit, All-llahu (xh.sh) e bëri obligim, me qëllim përvetësimin e përkushtimit në jetë dhe përhapjen e këtij shpirti kudo dhe me këdo!

TË DASHURIT E MI,

Të gjithë ju e keni dëgjuar dhe lexuar hadithin, që thotë: “Agjërimi dhe Kur’ani i ndërmjetësojnë robët tek All-llahu ditën e gjykimit. Agjërimi thotë: O Zot, unë ia ndalova ushqimin dhe epshet gjatë gjithë ditës, prandaj më prano mua për të! Ndërsa Kur’ani thotë: O Zot unë ia ndalova gjumin gjatë natës, prandaj më prano mua për të dhe i ndërmjetësojnë”²

1. Transmetuar nga Ahmedi në “El-Musned”, Bukhariu dhe Muslimi, nga Ebu Hurejra (r.a).

2. Transmetuar nga Ahmedi, Tabariani, Hakimi dhe Bejhaku, nga Ibni Amri (r.a).

Shqipëria e sotme është një vend i prapambetur, i izoluar dhe thuajse i mbytur në korrupsion, padrejtësi, anarshi e mosrespekt të fesë dhe besimit! Është gjynah Shqipëria e burrave të urtë të së kaluarës, të dëshmohej kjo që shohim e dëgjojmë sot!

Muaji Ramazan, është momenti më i mirë, për ta shfrytëzuar kohën, në gjurmët e Resulull-llahut (a.s), për të cilin thuhet, se: “Ishte më bujari i

**Muaji RAMAZAN,
VJEN PIKËRISHT PËR TË
NA BËRË MË TË VETËDIJSHËM,
SE KJO BOTË E PËRKOHSHME
DHE KJO JETË E SHKURTËR,
DUHET JETUAR DHE NDËRTUAR
ME FRYMËN E ZOTIT,
JO PAS THIRRJEVE SHTERPË
TË SHEJTANËVE, QË GJITHËSESI
NË KËTË MUAJ JANË TË LIDHUR!**

njerëzve në mirësi, por më së shumti e shfaqte atë në Ramazan...”³

Modelet e së shkuarës në marrëdhënie me këtë Muaj, janë pika referimi, që duhen shfrytëzuar, për të mos u bërë ky Muaj, fushë e tregtarëve të fesë, që vrapojnë në këtë muaj për të blerë e shitur, të veshur me matricën e Ramazanit dhe Fesë!?

Është mundësia për të gjetur vetveten, për të kërkuar Zotin, për të shijuar ëmbëlsinë e besimit, për të vendosur ekuilibrin në shpirt, për të ndjerë bekimet dhe mirësitë që zbresin nga lartësitë qiellore në tokën tonë të zhuritit e të tharë nga gjynahet dhe abuzimi historik, individual dhe kolektiv!

All-llahu ju dashtë dhe ju bekoftë!

3. Transmetuar nga Imam Muslimi.

MESAZH ME RASTIN E FILLIMIT TË MUAJIT RAMAZAN 1438/2017

Të dashur dhe të nderuar vëllezër dhe motra, besimtarë muslimanë, bashkëqytetarë,

Nëpërmjet këtij mesazhi dua t’ju përhapoj me zemër, në prag të Muajit të Madhërisë së Ramazanit 1438/2017, duke u lutur me shpirt që Zoti i gjithësisë t’ju lehtësojë agjërimin e tij, sakrificat dhe përkushtimin për t’u lartësuar drejt shkallëve më të spikatura të devotshmërisë në jetë!

Ky Muaj vjen si një mundësi ndryshimi dhe përmirësimi për jetën e gjithsecilit prej nesh, nëpërmjet kthimit të sinqertë e me zemër nga dyert e pendimit, adhurimit, bamirësisë, rrequllimit të marrëdhënieve familjare dhe atyre farefisnore, kthimit nga Kur’ani për ta lexuar atë me meditim dhe përsëritje, me qëllim angazhimin për t’u veshur me moralin e ajeteve të tij, në rruqëtimet e përsosjes së takvasë në jetën tonë.

Ramazani është Muaji i takimeve dhe i afrimeve, i shtimit të adhurimeve dhe i kontrollimit të nefsit, me qëllim mbylljen e shumë prej faqeve të hutimit dhe qabimeve të shkuara, si dhe hapjen e faqeve të reja të përkushtimit ndaj besës së Zotit dhe ndërtimit të urave të reja të harmonisë dhe besimit në shoqëri!

Ramazani ka në thelb të tij elementë të shumtë hyjnorë, si: mëshira, falja, toleranca, harmonia, distancimi nga e keqja, dhuna, terrori, ekstremizmi e fanatizmi i verbër e vrashtar, që prish çdo ekuilibër dhe shkatërron çdo urë lidhjeje me tjetrin në jetë! Fjalëkalimi i këtij Muaji: “Unë jam agjërueshëm!”, personifikon modelin e individit dhe shoqërisë së përgjegjshme për veprat, sjelljet, fjalët, si dhe dëshirën e mirë të ndërtimit të urave, distancimit nga çdo mendim e veprim që e dëmton tjetrin!

Ju ftoj me zemër që ta jetojmë këtë Muaj të paqimit dhe rritjes së harmonisë së besimit, si dhe të trupëzojmë në marrëdhëniet tona krejt elementët e tij hyjnor, që na shërbejnë për t’i dhënë më dinjitet e ndriçim, më bukuri e vlerë jetës sonë, marrëdhënieve tona shoqërore, vetë vlerave tona kombëtare!

Me zemër të mirë Ramazanin, ju të dashurit e mi, Shkodrës së dashur, Shqipërisë së shtrenjtë, mbarë ymnetit islam!

Paqja dhe bekimet e All-llahut mëshirëplotë mbuloftin me pelerinën e paqes mbarë botën tonë, krejt njerëzimin! Amin!

IMAM MUHAMED B. SYTARI
Myfti i ZONËS SHKODËR
Shkodër, më 25 maj 2017



AGJËRIMI FSHIN GJYNAHET



Ebu Hurejra (r.a) transmeton se Pejgamberi (a.s) ka thënë:

*“Kush e agjëron
Ramazanin
me besim, bindje
dhe vendosmëri,
atij i falen
të gjitha gjynahet
e kaluara.”*

(Buhariu dhe Muslimi)





Admir Plaku
Imam, xhamia "Ebu Bekër"

RAMAZANI, SI MUNDËSI E PAQTIMIT ME ZOTIN (XH.SH)

shumta për të ruajtur paqen me Allahun dhe fituar kënaqësinë e mëshirën e Tij. Allahu i përgjigjet lutjeve të lutësit kur ai është i sinqertë në adhurimin ndaj Tij.

Qëllimi i vetëm i agjërimit është që të jemi të devotshëm. Ai që e arrin shkallën e devotshmërisë i është pranuar adhurimi i tij. Kush e përjeton muajin e Ramazanit ka mundësinë e shansin për të përfituar paqen me Allahun, duke fshirë gjynahet që ka bërë që nga Ramazani i kaluar.

Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Tre personave nuk u kthehet lutja, (ndër ta): agjëruesit deri në iftar". Besimtari e ruan natyrshmërinë e tij të paqes duke shqiptuar mburojën e agjërimit "Unë agjëroj". Një mburojë vetëndërgjegjesimi e lirie në besimin në Allahun, një mburojë e ruajtjes së vlerës së ibadetit, një mburojë mirëkuptimi njerëzor pa u kritikuar dhe pa qenë dyshimtë, një mburojë e moralit të pastër, mburojë në sjellje pa e humbur pozitën sociale dhe shoqërore. "Unë agjëroj" një tregues i identitetit që duke e shqiptuar besimtari lartësohet e ndjehet krenar për besimin e tij, si për të dëshmuar se besimi jo vetëm ndihet me zemër por edhe jetohet.

Katërbëdhjetë shekuj më parë Pejgamberi (a.s) i përgëzoi besimtarët me ardhjen e muajit të Ramazanit, duke e përshkruar si muaji i bereqetit, muaji i mundësisë së paqimit me Allahun. Këtë muaj e përfshin një atmosferë; e veçantë shpirtërore, ripërtëritje besimi, pendesë, mbështetje tek Allahu (xh.sh) e përkushtimi në kryerjen e obligimeve.

Ndryshe nga të gjitha ibadetet e tjera, obligimit të agjërimit, Allahu (xh.sh) i parapriu me ajete parathënie. Duke treguar rëndësinë e tij në shoqëri, tregoi kategoritë që lehtësohen, e më pas na sjell në atmosferën e mundësisë së paqes me Allahun duke zbritur ajetin kuranor: "Kur robërit e Mi të pyesin për Mua, Unë jam pranë, i përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai më lutet Mua. Prandaj le t'i përgjigjen thirrjes Sime dhe të më besojnë Mua për të qenë në rrugë të drejtë." – (El-Bekare: 186) Në këtë ajet kuranor, Allahu (xh.sh) me urtësinë e Tij hyjnore na tregon atmosferën e paqes që vendoset me besimtarin e devotshëm. Falë kësaj paqeje që vendoset në këtë muaj, hapen dyert e xhenetit e mbyllen ato të xhehenemit.

Vlera e obligimit shumfishohet, ndërsa naflet vlerësohen në vlerën e farzeve. Në muajin e Ramazanit besimtarëve u ofrohen mundësi të

kur ai ruan harmoninë e dashamirësinë me njerëzit që e rrethojnë. Fakti që Allahu (xh.sh) e mëvetësoi agjërimitin dhe shpërblimin e tij duke e veuar nga ibadetet e tjera është urtësi hyjnore që tregon pozitën e agjëruesit, ndonëse njerëzor për nga sjellja e tij i vesh petk hyjnor. Allahu (xh.sh) me mëvetësimin e agjërimit dhe zbritjen e Fjalës së Tij hyjnore në këtë muaj, e nxiti besimtarin në ruajtjen e natyrshmërisë së pastër, besimin në Një Zot të vetëm, duke qenë i devotshëm në kryerjen e obligimeve, ashtu siç duhet.

Çdo minut, orë apo ditë në muajin e Ramazanit për agjëruesit është e vecantë, sepse nëse përjetohet, përjetësohet tek Allahu (xh.sh). Sepse kur ti agjëron bëhesh më i vetëdijshëm për sjelljen tënde, më i vetëdijshëm për gjuhën, sytë e për veshët e tu. Çdo organ e gjymtyrë e trupit kujton qëllimin e vërtetë të krijimit. Qëllimi i krijimit të njeriut ka një lidhje të ngushtë me ibadetin. Fryti i kësaj lidhje është paqja me Allahun, në muajin e mëshirës.

Ramazani vjen tek besimtari si një atmosferë paqeje, që përjetohet kundrejt një shpërblimi shumë të madh. Fakti që Ramazani nuk kufizohet vetëm me agjërimit, por edhe me ibadete të tjera ku secila prej tyre në këtë muaj ka vlerë e shpërblim më shumë sesa në muajt e tjerë. Le ta shndërrojmë këtë muaj paqeje në një sfidë me veten duke garuar me punë të mira e adhurime, si një përgjigje e porosisë së Allahut: "E për shpërblim të tillë, le të garojnë ata që lakmojnë të mirën". – (El-Mutaffinë: 26)

Lus Allahun që të na bëjë nga ata besimtarë, që e përjetonë Ramazanin në atmosferën e ibadetit.

"KUR ROBËRIT E MI TË PYESIN PËR MUA, UNË JAM PRANË, I PËRGJIGJEM LUTJEVE TË LUTËSIT, KUR AI MË LUTET MUA. PRANDAJ LE T'I PËRGJIGJEN THIRRJES SIME DHE TË MË BESOJNË MUA PËR TË QENË NË RRUQË TË DREJTË." – (El-Bekare: 186)



Durim Kasemi
Imam, xhamia Parrucë

SI TË PËRFITOHJËM NGA RAMAZANI?

prandaj duhen evituar që të kemi një Ramazan ndryshe dhe si rrjedhojë një vit tjetër ndryshe në raport me Allahun Fuqiplotë.

SË TRETI: PLANIFIKIM I PËRPIKTË

Kushdo që punon pa planifikim dhe pa organizim, kaplohet shpejt nga përtacia dhe shpenzon mundë shumë dhe arrin pak dhe, e kundërta gjithashtu. Duke u nisur nga kjo, për të përfituar sa më shumë nga ramazani duhet ta planifikojmë si do jetë dita dhe nata jonë gjatë muajit të ramazanit. Për këtë do të përmend disa vepra, të cilat janë të lehta për tu bërë dhe kanë shpërblim të madh, na mundësojnë të përjetojmë një Ramazan ndryshe dhe të përfitojmë sa më shumë prej tij, nëse i zbatojmë me përpikëri.

1. NJË SHTËPI NË XHENET ÇDO DITË

Falja e suneteve të namazeve para dhe pas tyre, është një punë e vyer dhe me shumë vlerë. Punë që nuk kërkon shumë prej nesh as kohë e as mund por, shpërblimin e ka të madh tek Allahu. Pejgamberi (a.s) na ka thënë: "Çdo musliman, i cili falë dymbëdhjetë rekate nafle – sunete te namazeve farz - në ditë, Allahu do i ndërtojë atij një shtëpi në xhenet". – (Muslim, nr.728)

2. NJË LUTJE PRANUAR ÇDO DITË

Ndër të mirat e shumta, që i janë dhënë agjëruesit është edhe lutja e pranuar. Abdulla Ibn Amr ibn As tregon se Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Agjëruesi ka një lutje të pranuar kur çel agjërimitin e tij". Abdullah ibn Amr transmetuesi i hadithit kur çelte iftarit lutej më këtë lutje: O Allah të lutëm ty, që mëshira jote ka përfshirë çdo gjë, të mi falesh gjynahet e mia. – (Ibn Maxheh, nr.1743, Hasen Shejh Shuajb)

3. MERITOJE DASHURINË E ALLAHUT

Ramazani është muaj i bashkimit dhe unitetit dhe kjo vërehet edhe nga natyra e tij unifikuese që në kohën e fillimit dhe mbarimit të tij që duhen të jenë një për të gjithë muslimanët si dhe nga iftari, namazet e teravive, etj. Nisur nga kjo duhet punuar për këtë drejtim në këtë muaj të bashkimit dhe forcimit të lidhjeve mes njëri tjetrit. Vend të veçantë në forcimin e këtyre lidhjeve zë edhe shkëmbimi i vizitave mes ta afërmeve dhe të njohurve me qëllim shtimin e dashurisë dhe vlerësimit të njëri tjetrit por edhe arritjen e dashurisë së Allahut në kë muaj me këtë punë. Në një hadith Kudsij Allahu

thotë: "E meritojnë dashurinë Time ata, të cilat vizitojnë njëri-tjetrin për hatrin Tim". – (Ahmed, nr.19438, Sahih, Shejh Shuajb) Dashuria e Allahut është arritje e madhe prandaj përmbaju kësaj veprë dhe mos humb asnjë rast për ta realizuar, sepse do të jesh i fituar.

4. MOS E LËR ISTIGFARIN PARA NAMAZIT TË SABAHUT

Minutat dhe momentet para syfryt janë nga më të vyerat momente, sidomos në Ramazan. Prandaj duhen shfrytëzuar dhe mbushur me punë të mira. Dhikri dhe dua ja janë ndër punët më të mira që veprohen në këtë periudhë, që shpesh mbushet me muhabet dhe punë që mund të kryhet në një moment tjetër gjatë ditës. Allahu thotë në suren Ali Imran, ajeti 17, pasi që përmend mirësitë materiale pas të cilave jepen njerëzit dhe vrapojnë pas tyre, tërheq vëmendjen drejt mirësisë së xhenetit dhe tregon se banorët e xhenetit në dynja: "Bëjnë istigfar në agim". Për këtë kohë Pejgamberi (a.s) thotë: "Allahu, pas një të tretës së natës, zbrit në qiellin e dynjasë dhe thërret: A ka kush që kërkon falje që ta fali?! A ka kush që kërkon diçka që t'i jap atij, e kështu derisa të hyjë koha e sabahut". – (Ahmed, 17904, Sahih, Shejh Shuajb)

5. AGJËRIM NJË DITË, SHPËRBLIM PËR DY DITË

T'i japësh iftar dikujt tjetër, një të varfëri, një miku, një të afërmi e kushdo qoftë ai, përveç se është një veprim fisnik tek njerëzit, forcon marrëdhëniet në mesin e besimtarëve dhe i ngre ata drejt niveleve më larta. Por mbi të gjitha këto, është shpërblimi i madh që ka kjo veprë tek Allahu. I dashtuni jonë (a.s) na ka thënë: "Kush i jep iftar një agjëruesi, e ka shpërblimin sikur ai që ka agjëruar, por pa iu pakësuar shpërblimi i tij". – (Ibn Maxhe, NR.1746, Sahih Albanian)

6. JE NJERIU MË I MIRË TEK ALLAHU

Ramazani është muaji i Kur'anit, sepse në të ka zbritur. Leximi i tij në këtë muaj është ndër punët më të dobishme dhe që plotësojnë ditën dhe natën e agjëruesit për tu lartësuar drejt përsosmërisë besimore në këtë muaj të begatë. Madje leximi dhe studimi i Kuranit në çdo kohë dhe veçanërisht në Ramazan është ndër punët, që i mundësojnë njeriut fitimin pozitës e të qënurit më i miri tek Allahu. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Më i miri prej jush, është ai që e mëson Kur'anin dhe ia mëson atë të tjerëve". – (Buhariu)



Ruzhdi Plangaj
Imam, xhamia Kiras

RAMAZANI MUAJI I HARMONISË ISLAME

cilin e transmeton Ebu Hurejra (r.a), Pejgamberi (a.s) thotë: “Nuk do të hyni në xhenet derisa të besoni dhe nuk do të besoni derisa të duheni me njëri-tjetrin, a t’ju tregoj për diçka, të cilën nëse e veproni do të duheni mes vete? Përhapeni selamin në mesin tuaj”.⁴

Abdullah ibn Selam (r.a) transmeton se: “Kur Pejgamberi (a.s) mbërriti në Medine, njerëzit u nisën drejt tij dhe u dëgjua një zë: “Erdhi i Dërguari i Allahut” (tre herë). Dola dhe unë me njerëzit që të shikoja, kur e pashe fytyrën e tij, kuptova që nuk është fytyrë gënjeshitari dhe fjalët e para, të cilat i dëgjova prej tij ishin: O njerëz, përhapeni selamin, ushqeni nevojtarët, mbani lidhjet farefisnore dhe faluni natën, ndërkohë që njerëzit janë në gjumë do të hyni në xhenet me paqë”.⁵

Ndërsa, Zoti (xh.sh) në Kur’anin Famëllartë thotë: “Dhe nxitoni (me punë që meritoni) në falje mëkatesh nga Zoti juaj dhe për në një Xhenet, gjerësia e të cilit është si gjerësia e qiejve dhe e tokës, i përgatitur për të devotshmit. Të cilët japin kur janë mirë edhe kur janë në vështirësi dhe që e frenojnë mllëfin, që u falin (keqen) njerëzve, e All-llahu i do bamirësit”.⁶

Ramazani është muaji i rregullimit të llogarive me familjarët, të afërmit, miqtë, shokët dhe të gjithë njerëzit duke lënë mënjanë prishaqefet dhe hatërmbetjet, mosmarrëveshjet, vetëm e vetëm për të fituar kënaqësinë e Allahut (xh.sh).

Transmeton Ebu Hurejra se Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Hapen dyert e xhenetit ditën e hënë dhe të enjte dhe i falen gjynahet çdo rob, i cili nuk i bën shirk Allahut, përveç atij personi që ka mes tij dhe vëllait të vet hasmëri. U thuhet: Vonojini këta të dy, derisa të pajtohen”.⁷

Islami ka treguar për vlerën dhe shpërblimin e njerëzve, të cilët lëvizin për pajtimin mes njerëzve që i kane prishur apo ndërprerë marrëdhëniet mes tyre, apo kanë hasmëri dhe armiqësi. Pejgamberi (a.s) ka treguar në hadithin, të cilin e transmeton Ebu Derda (r.a): “A t’ju tregoj për vlerën e një vepre, e cila është më e mirë se grada e agjërimit, namazit dhe sadekasë? I thanë: Sigurisht, o i Dërguar i Allahut. Tha: “Pajtimi mes

njerëzve”.⁸

Ky shpërblim i shprehur në këtë hadith të Pejgamberit (a.s) është gjatë tërë vitit, por po e veçoj me të Ramazanin, meqenëse Ramazani është muaji i shtimit të mirave.

Ramazani është muaji i durimit dhe vetëpërmbajtjes, largimit prej fjalëve dhe sjelljeve jo të hijshme, sepse ajo që shpreson njeriu si shpërblim është shumë më e mirë se hakmarrja momentale, apo kthimi i të keqes që të bëhet me të njëjtën monedhë.

Ebu Hurera (r.a) transmeton se, Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Nuk është agjërimiti vetëm ndalimi nga ngrënia dhe pija, por agjërimiti është ndalimi nga fjalët e kota dhe jo të hijshme. Nëse të shan dikush, apo sillet me injorance, thuaj: Unë jam agjërueshëm, unë jam agjërueshëm. Mos shaj, ndërkohë që je agjërueshëm, e nëse të shan dikush, thuaj: Unë jam agjërueshëm dhe nëse je i ngritur në këmbë, ulu ndenj”.⁹

Shtrimi i iftareve gjatë netëve të Ramazanit, dhënia e sadekasë, vizitat ditore të njëri-tjetrit, si dhe dhënia e sadekatul-fitrit janë tregues i interesimit për njëri-tjetrin, harmonizimit të marrëdhënies mes myslimanëve, ku të gjithë në fund të Ramazanit, shpresojnë faljen nga Zoti i tyre.

Gjithashtu, Ebu Hurejra (r.a) transmeton se, Pejgamberi (a.s) ka thënë: “I janë dhënë umetit tim në Ramazan pesë gjëra, të cilat nuk i janë dhënë asnjë umeti para tyre: 1. Era e gojës së agjëruesit është më e mirë tek Allahu, se era e miskut. 2. Melaiket kërkojnë falje për ta, derisa të çelin iftarin, 3. Shejtanët rebelë lidhen, kështu që nuk arrijnë tek ajo që kanë pas arritur, 4. Allahu e zbkuron xhenetin çdo ditë dhe thotë: shpresohet të largohet mudi nga robërit e mi dhe të vijë tek ti. 5. Iu falen gjynahet në natën e fundit. Thanë: O i Dërguar i Allahut, a është kjo nata e Kadrit?. Tha: Jo, por punëtorit i jepet shpërblimi pasi ta kryejë punën”.¹⁰

O Allah na bej prej atyre që i respektojnë prindërit, i mbajnë lidhjet farefisnore, respektojnë të gjithë shoqërinë dhe punojnë për pajtimin dhe harmoninë mes njerëzve.

8. Sunen Ebu Davud: 4919.

9. Et-Tergib vet-terhib: 1082, i saktë.

10. Et-Tergib vet-terhib: 586, (i dobët)/ zinxhiri i transmetimit është shumë i dobët, por për një pjesë të tij ka dëshmi në tekste të tjera të sakta. Shiko: Mexhalis shehr Ramadan, të Ibn Uthejmin, f. 8.



Adem Pizga
Imam, xhamia Perash

AGJËRIMI DHE SHËNDETI

agjërimit, me qëllim që njerëzit të bëhen të devotshëm. Por e parë në këndvështrimin material, unë dua t`i them vetes time dhe të gjithë atyre që agjërojnë: “Mos kini frikë nga agjërimiti. Vallahi, dobitë vijnë atje ku nuk jua merr mendja, se Zoti gjithmonë kur urdhëron për diçka, e urdhëron për të mirën e njeriut, edhe pse njeriu ndoshta mund të mos e kuptojë këtë të mirë”.

“Agjërioni, që të jeni të shëndetshëm.” - (Taberaniu)

Sot mjekët dhe shkencëtarët kanë shkruar libra për agjërimitin. Edhe pse nuk janë muslimanë, ata thonë: “Lum për ata që agjërojnë, sepse agjërimiti ka këtë dobi, këtë e këtë e kështu me radhë”.

Profesori rus, Nikolev Vanikov, në shkrimin e tij me temë “Liria për hir të shëndetit”, citon se agjërimiti luan një rol domethënës në pastrimin e organeve të trupit të njeriut nga papastërtitë, mbeturinat dhe lëndët helmuese. Ai çon në zhdukjen e tërë qelizave të dobëta që kanë rrethuar organin e tretjes dhe ndihmon në sekretimin dhe shkatërrimin e papastërtive nga stomaku dhe zorrët.

Shkencëtarët thonë, se agjërimiti ka dobi të mëdha për trurin, i cili është komandanti i jetës njerëzore. Gjatë agjërimit ulet kolesterolin në gjak dhe kjo do të thotë më pak goditje në tru. Prandaj është fakt që njerëzit që agjërojnë, nuk pësojnë goditje cerebrale dhe truri është më pak i rrezikuar, kur trupi agjëron.

Agjërimiti është shërim për lëkurën. Lëkura mbron trupin nga çdo sëmundje e jashtme. Kur trupi agjëron, bie niveli i ujit në gjak, bie niveli i lëngjeve të trupit dhe lëkura është më e thatë. Ajo duket se është më e dobët, por në fakt ajo bëhet më e fortë, sepse është më larg mikrobeve, ngaqë mikrobet synojnë të futen gjithmonë në ambiente që kanë shumë lëngje. Ka shumë njerëz, të cilët tregojnë se i kanë shëruar sëmundjet e lëkurës vetëm me anë të agjërimit.

Agjërimiti është kurim për zemrën, e cila është motori i jetës dhe nuk pushon asnjëherë. Gjatë agjërimit zemra pompon më pak gjak se herët e tjera, sepse 10% e gjakut shkon në aparatit të tretës, ngaqë aparati të tretës në Ramazan është më i qetë se në të gjithë muajt e tjerë. Kështu zemra pushon më shumë se herët e tjera dhe merr forca për 11 muajt e tjerë të vitit. Po ashtu pakësohet kolesterolin, i cili është shkaku kryesor i goditjeve në zemër.

Në një studim të paraqitur në konferencën e sëmundjeve të zemrës në Arabinë Saudite në shkurt të 1998, janë eksperimentuar mbi 86 të sëmurë me sëmundje të ndryshme të zemrës si p.sh, damarët apo valvulet e zemrës, 86 % e tyre arritën të agjërimitin tërë muajin e Ramazanit dhe vetëm 10 % e tyre u detyruan ta ndërprisnin atë disa ditë, dhe në përfundimin e muajit 78 % e tyre ndjen përmirësim të gjendjes shëndetësore.

Agjërimiti i bën mirë stomakut, atij mulliri që nuk di të pushojë 12 muajt e vitit. Ai punon natën e ditën, kur ti e ke mendjen dhe kur nuk e ke mendjen. Gjatë muajit Ramazan ai pushon pak më tepër. Nuk themi pushon totalisht, por ai është më i qetë se asnjëherë tjetër. Acidet, lëngjet tretëse pakësohen në stomak dhe kështu stomaku filtrohet dhe zorrët qetësohen në këtë muaj. Prandaj njerëzit që agjërojnë, e ndjejnë veten shumë më të lehtë.

Agjërimiti i bën mirë veshkave, filtrave të njeriut, të cilat nxjerrin jashtë për çdo ditë pa pushim helmet më të rrezikshme, që ekzistojnë brenda trupit tonë. Gjatë agjërimit pakësohet niveli i lëngjeve dhe këto filtra punojnë më kollaj se asnjëherë tjetër. Gjithë mbetjet e 11 muajve i nxjerrin më lehtë se asnjëherë tjetër.

Agjërimiti ndihmon në mënyrë efektive në shërimin e shqetësimeve psikike, forcon vullnetin e agjëruesit, sensibilizon e zbut ndjenjat e tij, i forcon dashurinë ndaj të tjerëve dhe e largon nga grindjet, ngacmimet dhe tendencat për veprime agresive ndaj të tjerëve, i kalit atij ndjenjën e shpirtmadhësisë, etj. Në këtë mënyrë agjërimiti forcon dhe mbështet personalitetin e njeriut, e bën atë me të fortë për të përballuar problemet dhe vështirësitë e jetës. Të gjitha këto, pa asnjë dyshim, pasqyrohen në mënyrë të vetvetishme në shëndetin e njeriut.

Kështu, duke agjëruar ne zbatojmë urdhrin e Allahut (xh.sh), duke përfutuar shpirtërisht dhe materialisht. Nga agjërimiti përfitojnë shpirtat tanë, mendjet tona dhe trupat tanë. Gjithashtu nuk duhet të harrojmë, se qëllimi kryesor i agjërimit është arritja e DEVOTSHMËRISË. Ai që arrin devotshmërinë është më afër Zotit dhe kush është afër Zotit ai nuk humbet kurrë as në dynja e as në ahiret.



Arben Halluni, teolog

Adhurimi shprehet dhe aplikohet në shumë forma dhe lloje të ndryshme. Ai shprehet konkretisht në fjalë, si p.sh.: dua (lutja), kujtimi dhe përmendja e emrit të Zotit (xh.sh), urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja, dhënia mësim, udhëzimi i të humburit dhe çdo gjë që sillet në këtë botë materiale.

Adhurimi gjithashtu shprehet edhe me vepër si p.sh.: Në aspektin truporë, siç është namazi, në atë financiarë, siç është zekati, ose në atë që i përfshin të dyja, si për shembull kryerja e Haxhit. Prej adhurimit që nuk përfshin as fjalë dhe as vepra, por vetëm ndalesa prej një gjëje është: Agjërimi, i cili do të thotë ndalesë nga ushqimi dhe pirja, si dhe nga marrëdhëniet intime nga lindja deri në perëndim.

Për agjërimin, si një adhurim i lashtë dhe i aplikuar ndër shekuj, Zoti me Madhërinë e Tij në ajetin kuranor 183, të sures "El-Bekare" thotë: "O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim, sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm". Nga ky ajet kuptojmë se agjërimi është një mënyrë e lashtë e ibadetit (adhurimit), i përcaktuar për ne myslimanët, si dhe për popujt që ishin para nesh, bile qysh prej kohës së njeriut të parë, babës së parë dhe Pejgamberit të parë të njerëzimit, Adem (a.s). Agjërimi formonte një obligim në secilin fe. Ai u njoh edhe prej egjiptianëve të lashtë, prej ku kaloi tek grekët e lashtë, të cilët e patën detyruar veçanërisht për gratë. Gjithashtu, edhe romakët dhe paganët patën agjëruar, e një gjë e tillë praktikohet edhe në ditët tona prej paganëve të ndryshëm. Disa nga ata popuj janë shfarosur, e disa jetojnë edhe sot, siç janë, kinezët, indianët, persianët, egjiptianët etj.

Fakti se institucioni i agjërimit haset edhe te popujt paganë, flet se

RAMAZANI, MUAJ I AGJËRIMIT NDËR SHEKUJ

edhe këtyre popujve ndonjëherë u kanë ardhur Pejgamberë me urdhëresa të njëjta ose të ngjashme, të cilat i ka shpallur edhe Kur'ani.

Ndërkohë që disa popuj agjërimin e kuptonin si vetmundim, duke mos ngrënë asgjë për një kohë të gjatë (brahmanët, budistët), të tjerët hanin, duke e lënë vetëm mishin dhe dhjamin e kafshëve.

Pra, ajeti i lartpërmendur tregon një fakt të qartë se agjërimi ka qenë i detyruar edhe për popujt e mëparshëm, një pjesë e madhe e të cilëve i kundërshtuan të dërguarit e Allahut (xh.sh), i ndryshuan dhe devijuan parimet kryesore të agjërimin sipas epsheve dhe dëshirave të tyre materiale.

Agjërimi te ithtarët e librit, si p.sh: Jehuditë lanë agjërimin e Ramazanit dhe vendosën të agjërojnë një ditë në vit, siç është dita Ashura, e cila personifikon shpëtimin e Musait (a.s) me fuqinë e Zotit (xh.sh), nga arroganca e Faraonit dhe shkatërrimin e këtij të fundit. Ndërsa besimtarët e krishterë shtuan një ditë para dhe një ditë pas, derisa arriti në 50 ditë dhe kur agjërimi u bë i vështirë në verë, e bënë fillimin e agjërimin në pranverë, lejuan ushqimin dhe pirjen, pa përdorimin e mishrave të kafshëve, etj.

Argumenti se agjërimi ka qenë detyrim edhe tek popujt e tjerë përpara nesh dëshmon qartë për rëndësinë e madhe që ka ky adhurim. A ka qenë obligim agjërimi një muaj, më pak apo më shumë kjo nuk dihet me saktësi, por ajo që është e rëndësishme të theksohet në këtë kontekst është se agjërimi është një adhurim nëpërmjet të cilit njeriu afrohet më pranë Zotit të Lartësuar.

Megjithëse nuk kemi shumë të dhëna, mjafton të përmendim ngjarjen e Musait (a.s), i cili shkoi të takohej me Allahun, ku agjëroi tridhjetë ditë dhe më pas agjëroi edhe dhjetë të tjera, nga dëshira që kishte që të rrinte sa më gjatë në takimin me Zotin (xh.sh).

Gjithashtu ajeti kuranor mund të shërbejë edhe si nxitje për ymetin islam që të garojë në kuptimin e mirë të fjalës me popujt e mëparshëm në kryerjen e veprave të mira që i kushtohen Krijuesit të gjithësisë.

Desh Madhnia e Zotit Fuqplotë që për ymetin e Profetit Muhamed (a.s)

këtë adhurim të veçantë ta obligojë në muajin e Ramazanit, pasi e kthej atë në të vërtetën e tij, në aspekt të ditëve, të kohës etj.

Nga ana tjetër, agjërimi përveç që është prezent te njeriu me shekuj, ai gjendet edhe te bota shtazore dhe bimore. Hulumtimet, studimet dhe eksperimentet kanë rezultuar se agjërimi, si adhurim i veçantë në kohë të caktuar është një çështje e natyrshme, të cilën Allahu (xh.sh) e ka vendosur tek krijesat e gjalla, për t'ua ruajtur shëndetin dhe për t'ua forcuar organet jetike të tyre. Përveç saj, agjërimi i kafshëve dhe i bimëve është një çështje e njohur. Ka prej tyre që agjërojnë një kohë të gjatë, deri në disa muaj; ka prej tyre që agjërojnë disa ditë, p.sh bimët agjërojnë një periudhë të gjatë dimri, deri që të nxjerrin gjethet e saj të freskëta dhe lulët e bukura në fillim të pranverës.

Një element tjetër që ia vlen të përmendet është se agjërimi si adhurim i veçantë dhe prezent ndër shekuj, ndahet në tri nivele: Agjërimi i përgjithshëm apo i zakonshëm, agjërimi i veçantë dhe agjërimi shumë i veçantë. Agjërimi i përgjithshëm është ndalimi nga epshet trupore, çka do të thotë largim nga ushqimi, pirjet dhe marrëdhëniet intime. Agjërimi i veçantë është që agjëruesi të ndalojë veshin, syrin, gjuhën, dorën, këmbën dhe të gjitha gjymtyrët nga ligësitë dhe mëkatet. Ndërsa agjërimi shumë i veçantë është agjërimi i zemrës nga ledhatimet e botës materiale dhe ndalimi i saj për të prekur atë çka ka ndaluar Allahu (xh.sh) dhe ky lloj agjërimi është agjërimi i Profetëve, evliave dhe atyre që vijojnë udhën e tyre të drejtë dhe të vërtetë.

Në fund, dua të falënderojmë Zotin e Madhërisë për këtë dhunti të madhe shpirtërore, morale dhe fizike që i ka dhënë njerëzve dhe të gjitha krijesave në kohë e vende të ndryshme, me qëllimin e vetëm siç përmendet edhe në Kur'an për të qenë më afër Madhërisë së Krijuesit të gjithësisë, për të cilën jemi krijuar në këtë botë. Pra për të qenë: Të devotshëm dhe adhurues të denjë ndaj Zotit (xh.sh).

Zoti na dhashtë mirësi, paqe dhe mbarësi në rrugëtimin tonë shpirtëror dhe material. Amin!

Adrian Uraj
Imam, xhamia Dudas

Nga Ebu Hurejre (r.a), thuhet se Profeti (a.s) ka thënë: "Kur hyn muaji i ramazanit, hapen dyert e xhennetit, mbyllen dyert e xhennemit dhe shejtani prangoset. Dhe një zë të thërret: O ti që kërkon të mirën dhe hajrin hajde! O ti që vrapon pas të keqes, heq dorë! "Pra, zbatimi sakte i kësaj thirrjeje, na bën prej atyre që korrin frutat e qetësisë shpirtërore në Ramazan. Përsëri, i Dashuri jonë (a.s) na tregon se: "Allahu (xh.sh) krenohet me të riun e devotshëm përpara melekëve dhe i thotë: O ti që braktise nefsin, epshin tënd dhe e sakrifkove rininë tënde për Mua, ti je për Mua siç janë melekët e Mi." - (Ibn Adij nga Ibn Mesudi) A ka më kënaqësi se sa të shohësh të rinjtë, në lulen e moshës së tyre t'i drejtohen kënaqësisë së Krijuesit!

Duhet të themi, që pikësepari agjërimi do të thotë të mbledhësh veten dhe të braktisë bukën dhe ujin. Kjo është një pjese ibadeti që nuk shihet. N.q.s adhurimet e tjera si namazi, haxhi, zekati shikohen, agjërimi është një vepër e fshehtë që shpërblimin e kësaj "E jap vetëm Unë", thotë Allahu (xh.sh), adhurim ky që karakterizohet nga durimi. Agjërimi është një mjet për të shkatërruar armikun e Allahut, sepse shejtani i afrohet njeriut me anë të epshit, dhe epshi forcohet duke ngrënë dhe duke pirë. Profeti (a.s) ka thënë: "Ashtu siç qarkullon gjaku nëpër damarë, ashtu qarkullon edhe shejtani brenda njeriut, prandaj ngushtojani rrugën nëpërmjet agjërimin." - (Buhariu)

Mirëpo, për të kuptuar se si arrihet qetësia shpirtërore, le të thellohem pak në mënyrën e agjërimin. Në mesin tonë është bërë traditë, që mos ha, mos pi dhe thuhet jam agjërueshëm. Deri këtu dakord, mirëpo a është ky mesazhi i Ramazanit, ku ne e kuptojmë se, agjërimi nuk mbaron me kaq? Se në fund të muajit themi: Si nuk ndjeva asgjë të veçantë në këtë muaj, pse nuk mu pranua dua në këtë muaj..?! Këtë na e sqaron Profeti (a.s) ku thotë: "Ka shumë njerëz që agjërojnë, por përveç urisë dhe etjes, për ta nuk ka sevap tjetër." Dhe pikërisht ky është problemi dhe pika kyçe ku duhet të vetëdijsohem. Neve na

RAMAZANI, MUAJI I QETËSISË SHPIRTËRORE

agjëron trupi por jo zemra. Si t'i gjejmë dhe identifikojmë këta njerëz që e kanë arritur qetësinë shpirtërore në Ramazan dhe jashtë tij? Këtu do i referohem Imam Gazalit (r.h), ku tek vepra e tij ne "Ihja", agjëruesit i ndanë në tre grupe, prej të cilëve po përmendim vetëm dy:

"Avvam", masa e gjerë. Në këtë grup janë ata njerëz që i ndalojnë vetes ushqimin, pijen dhe marrëdhëniet intime. Ky grup njerëzish nuk arrin të thellohet në urtësinë e qëllimit të agjërimin. Këta nuk e kontrollojnë gjuhën gjatë ditës në agjërim, dhe ndoshta vazhdojnë duke vepruar keq ndaj njerëzve. Është pak kontraktore që një njeri agjërueshëm t'i hyjë në hak atij tjetrit, ndoshta edhe me vetëdije, por jemi në një realitet, që kjo ndodh dhe ky grup njerëzish nuk mund ta arrijnë këtë kënaqësi shpirtërore në këtë muaj.

Në grupin e dytë, që është *grupi i salihineve* (njerëzve të përkushtuar e të mirë): Janë ata njerëz që agjërimi i tyre ia ruan të gjitha pjesët e trupit. Por për ta arritur këtë lloj gjendje dhe grade ekzistojnë 6 principe:

1- Ruajtja e syrit: Që d.m.th të heqësh shikimin nga ajo e gjë e ndaluar ose mekruh, e papëlqyer, sepse ajo ia përcjell pamjen zemrës dhe në vend që zemra të merret me përmendjen e Allahut, ajo bie në gaflet. Profeti (a.s) na thotë: "Të shikosh me shikim epshor, është një shigjete nga shigjetat e helmuara të shejtanit. Ai që e braktis këtë nga frika prej Allahut, që nuk e sheh pra, Allahu i mundëson atij një iman të tillë, saqë edhe zemra e tij e ndjen kënaqësinë." - (Hakimi nga Hudhejfe) Nga Xhabiri (r.a) transmetohet, se Profeti (a.s) ka thënë: "5 gjëra e prishin agjërimin: Gënjeshtria, gabeti (përgojimi), shpifja, betimi rrejshëm dhe të shikosh me epsh." - (Ezdii, Zuafa). Këtu të sqarohet diçka, që kur thuhet "e prishin" është kuptimi që ia pakëson sevapin dhe nuk arrin të ketë qetësi në shpirt, por jo se e bën të pavlefshëm.

2-Ruajtja e gjuhës: Ai person që e ruan gjuhën nga gënjeshtria, Tibeti dhe fjalët e pista, ai e ka gjetur këtë qetësi shpirtërore. Këti personi kur i vjen ndonjë nxitës grindjesh i thotë "jam agjërueshëm". Ky person e kalon kohën duke lexuar Kur'an, e kalon kohën me tesh në dorë duke përmend Allahun dhe duke çuar salavate, sepse në atë ditë llogarie, kjo gjuha jone prej mishit, do të dëshmojë se si është përdorur, dhe Allahu na befte nga ata që fjala e fundit, në frymën tonë të fundit, të jetë Teuhidi (la ilahe il'lall-llah).

3- Ruajtja e veshit: Pra, ta ruash veshin nga ato gjëra të pahijshme. Ashtu siç është e ndaluar për ta folur të keqen, ashtu është e ndaluar ta dëgjosh. Në Kur'an, Allahu thotë në suren El-Maide, ajeti 42 që: Janë ata që dëgjojnë gënjeshtren dhe hane haramin", pra i mbanë ne të njëjtin nivel. Të dëgjosh gabet, është po aq e ndaluar sa ta bësh atë.

4- Ruajtja e gjymtyrëve të tjera: D.m.th të ruash duart e këmbët nga veprimet e këqija. Të ruash stomakun në kohën e iftarit nga kafshata e dyshimtë. Sepse të mbash agjërimin me ushqim hallall dhe të hapësh iftarin me ushqim haram, nuk ka kuptim. Fjala është për kur je i ftuar për iftar diku. Shembulli i kësaj, thotë Imam Gazali, është si puna e atij që për të ndërtuar një shtëpi rrënon tërë qytetin.

5- Të hash pak në iftar: Iftar nuk do të thotë të hash e ta mbushësh barkun me ushqim hallallit. Tek Allahu është ndër gjërat e papëlqyeshme që të mbushësh stomakun deri në fyt, edhe nëse ushqim është hallall. N.q.s ato ushqime që nuk i ka ngrënë gjithë ditën, ulet e i ha me një vakt në iftar, atëherë ku qëndron lufta me epshin, nefsin që është armiku kryesor i Allahut?! Shumë njerëz në Ramazan gatujnë ushqime që nuk i gatujnë gjatë gjithë vitit dhe e mbushin sofrën me tëra të mirat. Jeta e Profetit (a.s), syfret dhe iftaret e tij janë të qarta: Qëllimi i agjërimin është të arrish devotshmërinë, ta ndjesh urinë e të varfrin, dhe të thyesh nefsin, egon, epshin.

Imam Gazaliu thotë që: Sekretin dhe shpirtin i agjërimin është të heqësh keq dhe të dobësohesh e të asgjësosh forcat negative që janë rruga e shejtanit tek ti. Dhe kjo është e mundur vetëm duke ngrënë pak, sidomos është nga edemi (edukata) e agjërimin që ditën kur të vjen gjumë, mos të flesh shumë dhe të ndjesh dobësinë e trupit dhe urinë.

6-Pas iftarit të jesh mes frikës dhe shpresës: Duhet t'i thotë vetes: A mos vallë jam nga ata që i është pranuar agjërimi, apo vallë mos jam nga ata që nuk i është pranuar dhe do të kenë dënim?! Kjo është ajo që duhet të mendojë, pra asnjëherë të mos jetë i sigurt për veprën e tij.

Pra me pak fjalë, ky njeri që arrin t'i zbatojë këto rregulla, arrin në qetësi shpirtërore gjatë këtij muaji të madhërueshëm. Të mundohemi ta gjallërojmë Ramazanin në familjet dhe në zemrat tona. T'i gjallërojmë xhamitë, si shtëpitë tona. T'i mësojmë fëmijët tanë me ndjenjën e përgjegjësisë ndaj xhamisë dhe gjithashtu një edem (edukatë) të bukur, ashtu siç e kemi pasur dikur.

“EDUKONI FËMIJËT TUAJ ME DASHURI PËR PROFETIN MUHAMMED (A.S.)” - DR. MUHAMMED A. JEMANI

(LIBËRI PËRKTHYER NGA H. VEHBI S. GAVOÇI - SHKODËR 1996)

JETA E PROFETIT (A.S.)

Sa mirë do të ishte që nënat të mbledhin djemtë e vajzat e veta dhe me ëmbëlsinë e zërit të tyre, plot respekt e dashuri t'u tregojnë rreth jetës së Profetit (a.s.)!

Sa mirë është që edhe baballarët ta bëjnë atë punë!

Sa mirë është që edhe shkollat të caktojnë një ditë në muajin Rebiul-ev-vel e ta quajnë dita e jetës Profetike, që të mblidhen mësuesit dhe nxënësit, me qëllim që të njohin jetën e Profetit që prej lindjes, derisa u rrit pak, si pësoi hidhërimet e jetimit, i lindur pasi i kishte vdekur babai, i vdiq e ëma duke e lënë vetem 6 vjeç, e pastaj i vdiq edhe gjyshi i dashur Abdyl Mut-talibi, kur ishte 8 vjeç.

Ai Zotëri u rrit me besim të thellë në Zotin e Madhërueshëm, pa iu përlurur kurrë idhujeve, me një edukatë e sjellje të përkryer, pa u ndikuar nga të rinjtë e tjerë në pije e punë të këqija, në imoralitet e kumar, të cilat në atë kohë ishin të zakonshme.

U martua në moshën 25 vjeçare me gruan e ndershme Hatixhe. Me të kaluan bashkë 25 vjet në harmoni të plotë, pa u prishur e larguar njëri nga tjetri. Fëmijët që u lindën, 4 vajza e dy djem i priti si një dhuratë e çmuar e Zotit. Ai nuk veptoi si disa fise arabe të asaj kohe, që kishin mëri për vajzat e, sapo u lindnin, i varrosnin si një pjellë e keqe. Jo, përkundrazi i deshi shumë dhe i priti me gëzim të veçantë.

Sa mirë është që fëmijët të njihen me veprimtarinë e Profetit Muhammed, me autoritetin që ai fitoi me sjelljen e tij dinjitoze e shumë të arsyeshme! Kështu p.sh. pasi u rrënuar Qabja e madhërueshme nga një shi i madh, e ndërjuan burrat, por, kur deshën ta vendosin Gurin e Zi në vendin e caktuar, ku kishte qenë herën e parë, kur e ndërtoi Hz. Ibrahim, doli një problem që duhej zgjidhur me urti. Kush do ta kishte nderin të vendoste gurin në vend të vet? Kjo mund të shkaktonte grindje mes fiseve. Një plak këshilloi që të mos grindeshin, por të prisnin deri sa të hynte i pari njeri nga dera Selam e Qabes dhe ai le të ishte gjykuesi i çështjes. Vendimi i tij do të zbatohej.

Pritën pak. Erdhi Muhammedi (a.s). Posa e panë, thanë: “Po. ky është Muhammedi Besnik, ne e pranojmë gjykimin e tij”.

E pyetën si të vepronin për ngatërresën. Ai Zotëri menjëherë kërkoi një pëlhurë të madhe, të vendosej Guri i Zi në të dhe të parët e fiseve ta kapnin prej një ane e ta sillnin në vendin e caktuar, në Qabe. E bënë këtë punë me kënaqësi. E kapi ai Zotëri me duart e veta të pastra Gurin e Zi dhe e shtiri në vendin e caktuar në një qoshe të Qabes së madhërueshme.

Kështu fiset arabe mbetën të kënaqur, e falënderuan Muhammedin që ndaloi grindjet ndërmjet tyre. Duhet ta dijë rinia këtë rast të shquar në jetën e tij të ndritshme, të madhëruar nga urtia e maturia.

Çfarë thamë deri tani kanë ndodhur para Profecisë. Ato kanë qenë parapërgatitje e mbështetje për misionin që ai ndërmoi më vonë.

Është mirë të fillohet studimi i jetës së Profetit që kur ai nisi të veqohej nga populli e të shkonte në malin Drita në shpellën Hira. Të dijë lexuesi se aty i erdhi meleku Xhebrail (a.s) herën e parë me REVELATËN dhe i këndoi pesë ajete të sures El-Alak:

“Lexo me emrim e Zotit tënd, icili krijoi (çdo gjë). Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur (në mitrën e nënës). Lexo! Se Zoti yt është më bujari! Ai që mësoi (njeriun) të shkruajë me pendë. I mësoi njeriut atë që nuk e dinte.”¹

Kështu përfitojnë fëmijët e rinia nga leximet e vrojtimit, se feja jonë është feja e shkencës, e diturisë, duke iu vërtetuar atyre se dija është mënyra se si, ata të njihen me Zotin (xh.sh). Dija e forcon besimin që përfitohet nga mendja dhe arsyeja. Dituria e shtyn myslimanin të kryejë vepra të mëdha e me vlerë në jetë.

Duhet të dijë rinia se Profeti (a.s) është zgjedhur nga Zoti (xh.sh) dhe është i mbarami i Profetëve.

Të mësojnë fëmijët dhe rinia ajetet e Kur'anit e të Haditheve (fjalë profetike) që flasin për Profetin Muhammed (a.s).

Profeti (a.s) ka thënë: “Zoti ka

1. Kur'ani, El-Alak: 1-5.

zgjedhur Keneanin, djalin e Ismailit, pastaj Kurejshin prej fisit të Keneanit, pastaj ka zgjedhur prej Kurejshit, Beni Hashimin e më ka zgjedhur mua nga Beni Hashimi”.

Duhet të dinë fëmijët dhe rinia se ata që kanë shkruar për jetën e Profetit (a.s) janë bashkuar rreth fisit të tij në një fjalë: se ai Zotëri është prej fëmijëve të Ismailit, djalit të Hz. Ibrahimit (a.s), të cilët ishin të aftë të drejtonin me burrëri, me sjellje të mirë, dorëdhënës. Ata vërtetë kanë qenë të zgjedhur, gjë që forcon në zemrat e fëmijëve dhe të rinisë çështjen se familja e Profetit (a.s) ka qenë familje e lartë, e pastër e se ai Zotëri ka thënë të vërtetën kur është shprehur: “Unë jam i zgjedhur”.

Le të mësojnë përmendësh fëmijët dhe të rinjtë emrat e nënës dhe të babait të gjyshit dhe të gjyshërve të atij Zotëri.

TRUNGU GJENEALOGJIK I FAMILJES SË PROFETIT MUHAMMED ËSHTË KY:

Muhammedi, djali i Abdullahut, djali i Abdyl Mut-talibit, djali i Hashimit, djali i Abdi Menafit, djali i Kuraj-jit djali i Kilabit, djali i Kaebit, djali i Fihrit, djali i Malikit, djali i Nadrit, djali i Kenanit, djali i Khuzejmes, djali i Muodtrikes, djali i Iljazit, djali i Mudarit, djali i Nizarit, djali i Meadit, djali i Adnanit, prej fisit të Hazreti Ibrahimit (a.s).

Nëna e tij është zonja Amine, vajza e Vehbit, djali i Menafit, djali i Zyhrasë, djali i Kilabit, djali i Kaebit, djali i Luej-jit, djali i Galibit, djali i Fihrit, ku bashkohet fisi i saj me fisin e Profetit (a.s).

Zonja Ummu Seleme nëpërmes shokut të Profetit, Ebu Hurejra kallëzon se ai Zotëri u pyet se kur ishte njohur si Profet. Ai u përgjigj: “Kam qenë Profet qëkur Hz. Ademi ishte ndërmjet trupit e shpirtit.”²

Kjo do të thotë se në dijeninë e Zotit ishte Profet, ndërsa, kur lindi, ai ishte Profeti i fundit.

Vetë ai Zotëri kallëzon: “Unë jam rob (rob i bindur) i Zotit dhe i fundmi i Profetëve, që në kohën kur Hz. Ademi ishte ende në baltë, unë jam premtimi që iu dha Hz. Ibrahimit dhe jam përgëzimi i Hz. Isasë”.

2. Transmetuar nga Tirmidhiu.

Nëse pyesin fëmijët dhe të rinjtë se, kur është njohur ai Zotëri për saktësi e besnikëri, ju përgjigjuni: “Ai është njohur për sjellje të mira qysh se e ka kuptuar jetën, deri në vdekje”.

Këtë e tregon dhe fakti që armiqtë e Kurejshit dhe çifutët, të gjithë janë bashkuar në një mendim: “Ai Zotëri ka qenë besnik e i pastër qysh në fëmijëri”.

Zoti xh.sh. në Kur'an thotë: “Ne të dërguam ty (Muhammed) vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat.”³ Këtë duhet ta dinë mirë të gjithë fëmijët dhe të rinjtë. Profeti Muhammed ka qenë mëshira e dhuruar nga Zoti xh.sh. për të gjitha krijesat.

Përsëri në Kur'anin e madhërueshëm thuhet: “Juve ju erdhi një i dërguar nga lloji juaj, atij i vjen rëndë për vuajtjet tuaja, sepse është lakmues i rrugës së drejtë për ju, është i ndijshëm dhe i mëshirshëm për besimtarët.”⁴

Hoxha Muhamed Ebu Zehra tregon se mëshira e Profetit (a.s) ka qenë me vlerë të plotë për të gjitha krijesat. Thuhet se ai Zotëri u pyet prej shokëve: “Na e përmende tepër mëshirën tënde, edhe ne kemi mëshirë për familjet tona?” Ai Zotëri u përgjigj: “Nuk dua atë mëshirë, dua mëshirën për të gjithë njerëzit.”

Duhet t'u kallëzojmë fëmijëve tanë, se ai Zotëri ka shëruar shpirtat e dobët me mëshirë dhe i shëron të skamurit me përdhimbje. Për këtë po përmendim disa ngjarje për të argumentuar çfarë u tha më sipër.

Erdhi një arab tek ai Zotëri për të lypur. I dha Profeti (a.s) çka kishte. Pastaj e pyeti: “A të dhashë sa ke nevojë? “Ai u përgjigj qartë: “Nuk më dhe”. Shokët e Profetit u pezmatuan nga përgjigja e arabit dhe u çuan në këmbë. Profeti i qetësoi dhe e mori arabin në shtëpi të vet. Aty i dha më tepër duke e pyetur: “A të dhamë çka deshe?” - Po, u përgjigj ai dhe e falënderoi.

Profeti (a.s) i kërkoi arabit që të nesërmen, në një kohë të caktuar të vinte e t'i thonte këto fjalë para shokëve, të cilët ishin zemëruar. Të nesërmen erdhi arabi dhe dëshmoi para të gjithëve se Profeti (a.s) i kishte dhënë sa ai kishte nevojë dhe e falënderoi.

Pastaj Muhammedi (a.s) shtoi: “Unë jam me ju si një bari me devenë e vet, që i ka ikur. U çuan njerëzit vrap pas saj për ta kapur, por ajo ikte më larg. Bariu u tha atyre që t'ia linin atij këtë punë, se vetëm ai mund ta ndiqte devenë e

3. Kur'ani, El-Enbija: 107.

4. Kur'ani, Et-Teube: 128.

SA MIRË ËSHTË QË EDHE SHKOLLAT TË CAKTOJNË NJË DITË NË MUAJIN REBIUL-EV-VEL E TA QUAJNË DITA E JETËS PROFETIKE, QË TË MBLIDHEN MËSUESIT DHE NXËNËSIT, ME QËLLIM QË TË NJOHIN JETËN E PROFETIT QË PREJ LINDJES, DERISA U RRIË...

vet. Ai ishte i mëshirshëm e ishte sjellë gjithnjë mirë me të. Kështu e lanë në punë të vet. Bariu mori pak bar, e thirri devenë dhe ajo iu afrua derisa ai e kapi për freri.

Sikur unë të ju lija ta dënonit arabin kur tha fjalën e parë, ai do të humbte e do të ishte pa ngrohtësinë e besimit e të mëshirës sime.”⁵

Gjykatësi Ijad, një prej dijetarëve të mëdhenj, në librin e vet “Shërim”, duke folur për të drejtat e Profetit (a.s) thekson se Zoti (xh.sh) i ka thirrur profetët e vet me emra Adem, Nuh, Ibrahim etj, ndërsa Profetin Muhammed (a.s) nuk e ka thirrur kurrë me emrin e nënës, por Profet ose i Dërguar.

Një dijetar, Abdurrahman Ibnul-Xhauzi, i cili ka shkruar mbi 500 libra, thotë se Zoti (xh.sh) nuk është betuar në emër të asnjë Profeti, përveç Profetit Muhammed (a.s), sepse ai është më i ndershmi i të gjithë Profetëve të tjerë. Për këtë në Kur'an thuhet: “Pasha jetën tënde (o Muhammed), s'ka dyshim se ata (populli i Lutit) ishin të humbur në dehjen e tyre.”⁶

Abdullahi, djali i Abasit, thotë: “Zoti (xh.sh) nuk ka krijuar asnjë krijesë më të dashur për Të, se Profetin (a.s) Lartësia e shkallës së tij kuptohet edhe nga fakti se Zoti (xh.sh) ka marrë besën e të gjithë Profetëve, që, nëse dërgohet në kohë të tyre Muhammedi (a.s) ata duhet të besojnë në të dhe ta ndihmojnë.”

Zoti xh.sh. në Kur'anë thotë: “Përkujtoni (o ithtarë të librit) kur Allahu mori zotimin e Pejgamberëve: nga ajo se juve ju dhashë libër e urtësi, ju patjetër do ta besoni dhe ndihmoni pejgamberin që vjen pas jush,

5. Siretu Ibn Hisham.

6. Kur'ani, El-Hixhr: 72.

e që vërtetohet atë që keni pranë vetes. Tha (Allahu): “A pranuat, a e morët përsipër obligimin Tim? Ata thanë: “Ne e pranuat! “Tha (Allahu): “Dëshmoni pra, edhe Unë dëshmoj bashkë me ju.”⁷

Xhabiri (r.a) transmeton se Profeti (a.s) ka thënë: “Mua më janë dhënë nga Zoti pesë gjëra të cilat nuk i janë dhënë kujt tjetër para meje:

1. Jam ndihmuar në luftë nga Zoti (xh.sh) duke futur frikën në zemrat e armiqve një muaj rrugë larg.

2. Toka më është bërë vend faljeje e pastrimi. Kushdo nga besimtarët e mi (populli im), kur vjen, kudo mund të falet e të bëjë tejemumm me dhe.

3. Më janë lejuar plaçkat e luftërave, ndërsa më parë nuk i janë lejuar askujt.

4. Secili Profet i është dërguar popullit të vet, kurse unë i jam dërguar mbarë njerëzimit.

5. Më është dhënë shefaati (ndërmjetësimi).”⁸

PËR CILËSITË MORALETË PROFETIT (A.S) KA SHUMË TREGIME DHE NGJARJE INTERESANTE QË DUHET T'U KALLËZOHEN FËMIJËVE.

Po përmendim disa syresh.

Një vajzë po qante në rrugë. U ndal Profeti (a.s) dhe e pyeti se, pse po qante. Ajo iu përgjigj se kishte humbur paratë e miellit që e kishte dërguar zotëria të blinte.

Profeti Muhammed (a.s) i dha vajzës paratë sa kushtonte mielli, por ajo nuk e ndaloi vajin. E pyeti përsëri se, pse qante. Vajza e mjerë u përgjigj: Të lutem, thuaji zotërisë të mos më dënojë për vonesën.

Profeti (a.s) e mori vajzën e vogël për dore, e çoi tek shtëpia e zotërisë dhe i kërkoi që të mos e ndëshkonte.

Ai Zotëri i donte shumë fëmijët, sillej mirë me to dhe i përkëdhelte.

Hasani e Hyseni shpeshherë i hipnin në shpinë e, kur ishte në namaz, e zgjaste sexhden, që t'i kënaqte sa më shumë fëmijët.

Kur gjatë faljes dëgjonte ndonjë fëmijë duke qarë në xhami, e shkurtonte këndimin e Kur'anit.

Këto tregime e të tjera si këto flasin qartë se Zoti (xh.sh) e ka lartësuar gradën e Profetit dhe e ka pajisur me të mirat që ka dashur.

(vijon në numrin e ardhshëm...)

7. Kur'ani, Ali Imran: 81.

8. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslim



Lavdrim Hamja
Imam, xhamia e "Dy Vajzave"

RAMAZANI, MUAJI I BAMIRËSISË

për të cilën na ka lajmëruar Pejgamberi (a.s) duke thënë: "Ju erdhi Ramazani muaji i begative të Allahut në të cilin zbret mëshira, fshihen gjynahet dhe pranohen lutjet..." - (Tabaraniu)

Gjithashtu, për bujarinë e Allahut (xh.sh), veçanërisht për muajin e begatë të Ramazanit, tregon edhe ky hadith i Pejgamberit (a.s), i cili thotë kështu: "I janë dhënë ymetit tim pesë gjëra në Ramazan, të cilat nuk iu janë dhënë asnjë pejgamberi përpara meje:

E para: Në natën e parë të Ramazanit, Allahu e shikon umetin tim dhe atë që Allahu e shikon nuk e dënon kurrë.

E dyta: Shija e gojës së agjëruesit në mbrëmje është më e mirë tek Allahu se sa era e miskut.

E treta: Engjëjt kërkojnë falje për ta çdo ditë e natë.

E katërta: Allahu (xh.sh) urdhëron xhenetin e Tij duke i thënë: Përgatitu dhe zbukurorhu për robërit e Mi. Pothuajse janë afuar të pushojnë prej lodhjeve të dynjasë për në strehën dhe në xhenetin Tim.

E pesta: Në natën e fundit, Ai i ka falur të gjithë.

Një njeri e pyeti: Ajo natë është nata e Kadrit? Pejgamberi (a.s) tha: Jo, a nuk i ke parë punëtorët, të cilët punojnë dhe kur e përfundojnë punën, atëherë e marrin shpërblimin." - (Bejhakui, Imam Ahmedi dhe Bezari)

Në Kur'anin Famëlartë do të gjejmë shumë ajete, të cilat nxisin për bamirësi dhe tregojnë për shpërblimin dhe pozitën e lartë që kanë njerëzit bamirës, bujarë dhe zemërgjerë. Allahu i Madhëruar, përmes Fjalës së Tij thotë kështu në disa ajetet: "Shembulli i atyre, të cilët e shpenzojnë pasurinë e tyre në rrugën e Allahut, është sikur shembulli i kokrrës së farës, që mbinë shtatë kallinj, në secilin kalli njëqind

kokrra. Allahu ia shton atij që do. Allahu është Bujar, i Ditur". - (El-Bekare: 261)

"Nuk ka mirësi në shumicën e bisedave të tyre, përveç atij që urdhëron për ndonjë lëmoshë (sadeka), ose bamirësi, apo për pajtim mes njerëzve. Dhe, kush vepron kështu, duke kërkuar kënaqësitë e Allahut, Ai do t'i dhurojë shpërblim të madh". - (En-Nisa: 113)

Bamirësia ka qenë cilësi dhe karakteristikë e gjithë Profetëve të Zotit dhe duke qenë se ata janë shembulli më i përkryer i besimtarëve që duhet ndjekur, sipas Fjalës së Zotit (xh.sh), ku thotë në Kur'anin Famëlartë: "Me të vërtetë, ju në ta keni shembullin më të mirë, për atë që beson Allahun dhe Ditën e Fundit. E, kush largohet (prej këtij shembulli), me të vërtetë Allahu, Ai është i Pasuri, i Falënderuari". - (El-Mumtehine: 6)

Prandaj, duhet që besimtari të ecë në shembullin e tyre dhe të karakterizohet me këtë cilësi fisnike, e që është bamirësia.

Ndërsa, Pejgamberi ynë (a.s), pa dyshim ka qenë shembulli më i përkryer në bamirësi dhe dhurim. Nuk transmetohet asgjëkund, që ai Zotëri të ketë kursyer, apo të mos i ketë dhënë dikujt, i cili mund t'i ketë kërkuar diçka. Gjithë atë që zotëronte, madje edhe ato pasuri, të cilat Zoti (xh.sh) ia dhuroi prej plaçkave të luftës etj, ai i dha për bamirësi dhe ndihmë të të tjerëve.

Ai gjithmonë dhe gjatë gjithë jetës së tij ka qenë bujar, fisnik dhe zemërgjerë. Çdokush që i kërkonte diçka, ai ia jepte. Ndërsa bujaria dhe zemërgjerësia e tij në Ramazan, me të vërtetë ka qenë e papërshkrueshme. Mjafton ajo që transmeton Ibn Abbasi (r.a) se: "Pejgamberi (a.s) ka qenë më bujar i njerëzve në bujari dhe ka qenë më bujar, sidomos në Ramazan ... Xhibrili (a.s) e takonte çdo natë të Ramazanit

dhe Pejgamberi (a.s) e lexonte Kur'anin përpara tij. E kur e takonte Xhibrili (a.s) ai ishte më bujari në bujari sesa era siharique e shiut". - (Buhariu)

Ky hadith në veçanti tregon se muaji i Ramazanit është muaji i bamirësi dhe bujarisë. Nuk ka kohë tjetër më të mirë, sesa muaji i Ramazanit për ta treguar veten besimtari se e pason të Profetin e tij (a.s), duke bërë bamirësi, të çfarëdo lloji qofshin ato.

Ja edhe disa hadithe, të cilat flasin dhe nxisin për bamirësi të ndryshme, e në qoftë se ne si besimtarë, pasojmë me të vërtetë të Dërguarin e Allahut (a.s), patjetër që sipas mundësive, të cilat na i ka dhënë Zoti (xh.sh), duhet të japin shembullin tonë e të tregohemi besimtarë me vepra, e jo vetëm me fjalë.

Ibn Umeri (r.a) tregon se Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Më i dashuri i njerëzve tek Allahu është më i dobishme i tyre dhe më e dashura punë tek Allahu (a.xh) është të gëzuarit e myslimanit, apo t'i largosh atij një telash, apo t'i shlyesh një borxh, apo t'ia largosh urinë. Të ecë me vëllanë tim mysliman në nevojën e tij, është më e dashur për mua, sesa të bëjë itikaf (të qëndroj në adhurim) një muaj! Kush zotëron zemërimin e tij, Allahu ia mbulon të metat e tij dhe kush e mban mllefin, që nëse do e shpërthen atë, Allahu ia mbush zemrën me kënaqësi Ditën e Kiametit. Dhe, kush ecë me vëllanë e tij mysliman në nevojë që ka, derisa t'ia kryejë, Allahu ia forcën këmbët e tij, ditën që rrëshqasin këmbët. Sjellja e keqe e prish punën, ashtu siç uthulla e prish mjaltin". - (Ibn Veheb në "El-Xhamiu", Tabaraniu në "El-Mu'xhem El-Evsat")

"Kurrë nuk pakësohet pasuria duke dhënë sadeka". - (Muslim)

"Kur vdes njeriu i ndërpritet puna e tij, përveç tre gjërave: Bamirësia, dituria e dobishme, ose fëmija i mirë, që lutet për të". - (Muslim)

Në fakt porosinë e Pejgamberit (a.s) janë të shumta dhe me mjaft vlerë e dobi, për çdo njeri, i cili dëshiron të ndjekë rrugën e bamirësisë, por koha nuk na mjafton për t'i sjellë gjithë ato porosi, vetëm se në mbylljes dua sjellë në vëmendje, se ai njeri që bëhet shkak i mirë në rrugën e bamirësisë dhe sjelljes së mirë, ka dy shpërblime, shpërblimin e parë për bamirësinë që vetë ka kryer dhe shpërblimin e dytë për shembullin e mirë që ka lënë tek njerëzit, e ata e pasojnë atë shembull.

Po e përfundoj me ngjarjen, të cilën e

transmeton Xherir ibn Abdullah (r.a) ku thotë: Një ditë paradreke, duke ndenjur te Pejgamberi (a.s) erdhën disa njerëz të varfër, pothuajse të zhveshur. Ata ishin prej fisit Mudarr. Fytyra e Pejgamberit (a.s) ndryshoi në çast kur i pa në atë gjendje të mjerueshme. Hynte dhe dilte jashtë. Urdhëroi Bilalin të thërrasë ezanin. Fali dy rekatë namaz, pastaj mbajti një fjalim.

"O ju njerëz! Kini frikë Zotin tuaj që ju ka krijuar prej një vete dhe nga ajo krijoi bashkëshorten e saj, e prej atyre të dyve u shtuan shumë burra e gra. Dhe kini frikë Allahun që me emrin e Tij përbetoheni, ruajeni farefisën, se Allahu është mbikëqyrës mbi ju."

"O ju që keni besuar, kini frikë Allahun dhe secili nga ju le të shikojë se çfarë ka përgatitur për nesër." Secili njeri le të japë ndonjë dinar dhe dirhem, apo rrobë, ndonjë drithë apo hurmë, madje qoftë edhe një gjysmë hurmi".

U ngrit një njeri dhe solli disa hurma, pastaj menjëherë pas tij filluan njerëzit e tjerë të dhuronin, deri sa u bënë dy grumbuj të mëdhenj, me ushqim dhe me rroba. Pashë se fytyra e Pejgamberit (a.s) filloi t'i ndriçojë, pastaj tha: "Kush bën një synet të mirë në Islam (sjell diçka të re të mirë), ai ka shpërblimin e atij syneti dhe shpërblimin e atyre që e punojnë atë synet, pa iu pakësuar gjë prej shpërblimit të tyre. Dhe kush bën një synet të keq në Islam (sjell diçka të re të keqe), ai ka gjynahun e atij syneti dhe gjynahun e atyre që e punojnë atë synet, pa iu pakësuar gjë prej gjynahut të tyre." - (Muslim)

Patjetër një ditë do të largohemi nga kjo botë dhe pas do të lëmë të gjithë pasurinë tonë, shtëpi, familje, makina, para etj. Asgjë nuk do të na shoqërojë në rrugën e pakthyeshme dhe të përhershme për në botën tjetër, përveç se besimi, sinqeriteti dhe veprat e mira që kemi bërë. Prandaj, kush dëshiron që mirësitë dhe begatitë që ka në këtë botë, t'i trashëgojë dhe t'i ketë edhe në botën tjetër, madje më të mira, atëherë le të kujtohet dhe të shpejtojë në bamirësi sa të jetë gjallë:

"Jepni nga ajo që Ne ju kemi dhënë, para se ndonjërit prej jush t'i vijë vdekja, e atëherë të thotë: "O Zoti im, sikur të ma kishe shtyrë edhe pak vdekjen, që të jepja sadeka e të bëhesha prej të mirëve! Allahu kurrë nuk e shtyn askënd për më vonë, kur atij i vjen vdekja. Allahu është i njohur plotësisht me atë që punoni." (Munafikun: 11)

"RAMAZANI MIDIS NESH"



Myftinia Shkodër

JU FTON TË NDIQNI EMISIONIN:

"RAMAZANI MIDIS NESH",

NË TV1 CHANNEL,

ÇDO TË MARTË,

TË ENJTE

DHE TË SHTUNË,

NË ORËN: 19.30

DHE RITRANSMETIMIN,

ÇDO TË MËRKURË,

TË XHUMA

DHE TË DIEË,

PAS SYFYRIT.

EMISIONET MUND

T'I NDIQNI LIVE

EDHE NË ADRESËN ZYRTARE TË

TELEVIZIONIT:

(WWW.TV1-CHANNEL.TV)



"Kurrë nuk pakësohet pasuria duke dhënë sadeka" .- (Muslim)





Naim Drijaj

Imam, xhamia Parrucë

NATA E KADRIT, MË E MIRË SE 1000 MUAJ

Muxhahidi thotë: "Nata e Kadrit është më e mirë se 1000 muaj. Puna, agjërimi dhe falja në këtë natë është më mirë, sesa të punosh, të agjërosh dhe falesh për 1000 muaj rresht, pa e përfshirë këtë natë në llogari".⁵

Profeti Muhammed (a.s) na paralajmëron dhe na këshillon që kjo natë të mos na gjejë indiferentë dhe gafila, por duke u falur dhe lutur. Ebu Hurejra (r.a) tregon: "Kur vinte muaji i Ramazanit, i Dërguari i Allahut (a.s) thoshte: "Ju erdhi muaji i begatë i Ramazanit...Në këtë muaj është një natë, e cila ka vlerë më shumë sesa 1000 muaj. Kush nuk përfiton prej saj, ka humbur të gjitha mirësitë".⁶

Kur'ani Famëlartë si dhe tradita profetike, e theksojnë rëndësinë dhe vlerat e mëdha të natës së Kadrit. Madje, Kur'ani përmban dhe një sure, e cila mban këtë emër dhe flet pikërisht për këtë natë. Nata e Kadrit është nata më e rëndësishme në jetën tonë, të cilën nuk duhet ta kalojmë si netët e tjera, pasi nga kjo natë varet e kaluara dhe e ardhmja e jonë.

Kurani i lartësuar e ka graduara këtë natë, saqë edhe emrin ia ka vënë pikërisht "Nata e Vlerës dhe Shkallës së lartë - Kadr". E çfarë vlere dhe grade më të lartë mund të ketë një natë, sesa të konsiderohet si nata më e mirë se një mijë muaj të tjerë që nuk kanë natë Kadri?

Një mijë muaj, janë të barabartë me 83 vite e katër muaj. Kjo natë është më e mirë se një jetë e gjatë e jetuar nga njeriu, një jetë e afërt me një shekull. Allahu i Madhëruar na lajmëron, se e ka zbritur Kur'anin në natën e Kadrit. Ajo është nata e madhe, për të cilën Zoti thotë: "Ne e zbritëm Kur'anin në një natë të bekuar...".¹

Kjo natë është nga netët e muajit të Ramazanit, për të cilën Allahu (xh.sh) thotë: "Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kur'ani...".² Ibn Abasi (r.a) thotë: "Allahu e ka zbritur përnjëherësh Kur'anin nga "Pllaka e Ruajtur" në qiellin e kësaj bote, më pas i ka zbritur të Dërguarit të Allahut sipas ndodhive që kanë ndodhur për një periudhë 23 vjeçare".³ Allahu i Madhëruar, duke e lartësuar Natën e Kadrit, në të cilën u shpall Kur'ani, thotë: "E kush mund të ta shpjegojë ty se ç'është nata e Kadrit? Nata e Kadrit është më e mirë se një mijë muaj".⁴

Fjala e Allahut të Madhëruar: "Melekët dhe Shpirti (Xhebraili), me lejen e Zotit të tyre, zbresin në këtë natë, me të gjitha vendimet", nënkupton, se zbresin shumë melekë. Ata zbresin me begatinë dhe mëshirën e Zotit, ashtu siç zbresin kur lexohet Kur'ani apo kur marrin pjesë në tubimet e dhikrit. Fjala "Shpirti" i përmendur në këtë ajet, nënkupton Xhibrilin (a.s).

Allahu (xh.sh) thotë: "Në këtë natë zgjidhet çdo çështje në mënyrë të prerë".⁸ Shprehja në këtë natë zgjidhet çdo çështje në mënyrë të prerë do të thotë: Se në këtë natë vendoset fati i të gjitha krijesave për vitin e ardhshëm. Në këtë natë shkruhet se kush do të jetojë, kush do të vdes, kush do të shpëtojë etj.

"Kjo natë është paqe deri në lindjen e agimit"⁹ Muxhahidi thotë: "Kjo është nata e paqes, në të cilën shejtani nuk ka mundësi të bëjë keq dhe as të dëmtojë".¹⁰

I Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë: "Kush e kalon Natën e Kadrit në adhurim, me besim të sinqertë dhe duke shpresuar shpërblimin nga Allahu, i falen të gjitha gjynahet që ka bërë më parë".¹¹

Mendimet lidhur me natën e Kadrit, i ka numëruar Ibnu Haxheri, i cili thotë se janë 46 mendime të ndryshme. Por, mendimi më i qëlluar mbetet ai që thotë se kjo natë është në një nga netët teke të dhjetë ditshit të fundit të Ramazanit.

5. Abdurrazaku në Tefsir 2/386.

6. Ahmedi 2/385, Bejhakui në Shuabul İman nr.3328.

7. Kur'ani, El-Kadr: 4.

8. Kur'ani, Ed-Duhan: 4.

9. Kur'ani, El-Kadr: 5.

10. Bejhakui në Shuabul iman nr.3425.

11. Buhariu 35,1901, Muslimi nr.760.

Aishja (r.a) tregon se Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Kërkojeni natën e Kadrit në netët tek të 10 ditëshit të fundit të Ramazanit".¹²

Nga një sërë hadithesh, kuptohet qartë që nata e Kadrit është në dhjetë ditshin e fundit të Ramazanit. Vetë Aishja tregon "I dërguari i Zotit (a.s) mbyllej në itikaf dhjetë ditë e fundit dhe na thoshte: "Kërkojeni natën e Kadrit në dhjetë ditë e fundit të Ramazanit!"¹³

Meqë fillimi i ditës së Ramazanit ndryshon nga një vend në një tjetër, siç vihet re, netët teke në disa vende, janë çift në vende të tjera teke, prandaj dhe lipset që nata e Kadrit të kërkohet në të gjitha netët e dhjetë ditëve të fundit.

Urtësia e fshehtësisë së kësaj nate

Ka shumë urtësi në fshehtësinë e kësaj nate. Nëse të gjithë do e dinim me përpikmëri natën e Kadrit, vendosmëria dhe vullneti gjatë Ramazanit do të pësonte rënie. Njerëzit, thjesht do i kushtonin rëndësi dhe vëmendje pikërisht kësaj nate, të cilën do e kalonin në adhurim dhe punë të mirë dhe kaq. Prandaj, fshehja e saj shihet si një motivim për më shumë punë gjatë gjithë muajit dhe një dyfishim i punëve të mirë sidomos gjatë dhjetë ditëve të fundit të Ramazanit.

Nga shenjat e kësaj nate janë: Natë e qetë, e shndritshme, as e ftohtë as e ngrohtë, pa re, hëna është e pastër, lindja e diellit pa rreze, sikur të ishte hënë 14-she. Në këtë ditë shejtanët nuk ngrihen me lindjen e diellit".¹⁴

Të gjitha këto shenja, nuk janë të prera dhe nuk arrijnë në gradën e sigurisë së plotë. Ato mund të gjenden ose jo, sipas vendit dhe stinës. Ka vende myslimane ku shiu bie pa pushim, të tjera ku ka vite që nuk bie shi, të tjera që vuajnë nga të ftohtit dhe të tjera që vuajnë nga i nxehti.

Aishja (r.a) e ka pyetur Pejgamberin (a.s) "O i Dërguari i Allahut! Nëse unë e përjetoj Natën e Kadrit, si t'i lutem Allahut (xh.sh)? Pejgamberi (a.s) i ka thënë "Thuaj: "O Allah! Ti je Falës i Madh, e do faljen, më fal mua!"¹⁵

12. Buhariu nr.2017, Muslimi nr.1169.

13. Buhariu, Muslimi.

14. Bejhakui në Kubra 4/311, Ahmedi 5/318.

15. Tirmidhiu nr.3513, Ibn Maxheh nr.3850, Ahmedi 6/171.



Altin Nikshiqi

Imam, xhamia "Ebu Bekër"

"MUAJI I RAMAZANIT, NË TË CILIN ZBRITI KUR'ANI"

KUR'ANI NUK ËSHTË THJESHT NJË LIBËR BESIMI, QË MBUSH ZEMRAT DHE SHPIRTRAT ME DEDITË, POR AI ËSHTË LIQJI DHE PROGRAMI I JETËS SË NJERIUT.

Ramazani në vetvete është muaji i Kur'anit. Shkaku që e bën këtë muaj të bekuar, është zbritja e Kur'anit në të. Këtë fakt e shpreh dhe ajeti i lartë përmendur.

All-llahu i Lartësuar e ka përzgjedhur muajin e Ramazanit ndaj gjithë muajve të tjerë me zbritjen e Kur'anit. Çdo vit, pikërisht në muajin e Ramazanit, Xhibrili (a.s) ia lexonte Profetit (a.s) Kur'anin, ndërsa në vitin që Profeti (a.s) ndërroi jetë, ia lexoi dy herë. Çdo natë të Ramazanit, Profeti (a.s) bashkë me Xhibrilin (a.s) lexonin së bashku Kur'anin.

Ibn Abasi (r.a) përcjell: "I Dërguari i All-llahut ishte më bujari i njerëzve, ndërsa në Ramazan bujaria e tij arrinte kulmin, pasi ai (a.s) takohej me Xhibrilin. Në bamirësi Profeti (a.s) ishte më i fuqishëm se era e fuqishme."

Nga kjo që lexuam nxjerrim dy çështje të cilat duhet ti ketë gjithë se cili nga ne që të ndjekë rrugën e të Dërguarit (a.s):

- Vlerën e leximit të Kur'anin

- Bamirësinë e këtij muaji të begatë

Kur'ani, ky burim i orientimit dhe i rrugës së drejtë për besimtarët, është një libër që duhet jo vetëm lexuar gjithmonë, por edhe duhet menduar e medituar në të. Të lexosh Kur'anin, është sikur të flasësh me Zotin (xh.sh). Nëse një njeri me pozitë apo me famë në këtë botë, do të na fliste, ose do të na takonte, kjo do të ishte një gjë e madhe për ne dhe do tua tregonim të afërmve dhe shokëve këtë gjë. Nga ana tjetër, ne harrojmë faktin, se kur lexojmë Kur'anin, ne komunikojmë drejtpërdrejt me Krijuesin e Madhëruar. Sa gjë me vlerë dhe e bukur! Sa na ka vlerësuar Zoti, kur ka pranuar të flasë me ne!

Në këtë muaj nuk ka zbritur vetëm Kur'ani, por edhe fletushkat dhe librat e tjerë të shenjtë.

Për këtë i Dërguari i All-llahut (a.s)

ka thënë: "Kanë zbritur fletushkat e Ibrahimit (a.s) në natën e parë të muajit Ramazan, Teurati ka zbritur mbasi kanë kaluar gjashtë ditë nga muaji Ramazan, Inxhili ka zbritur mbasi kanë kaluar trembëdhjetë ditë të muajit Ramazan, Zeburi ka zbritur mbasi kanë kaluar tetëmbëdhjetë ditë të muajit të Ramazanit, ndërsa Kur'ani ka zbritur mbasi kanë kaluar njëzet e katër ditë të muajit të Ramazanit".

Në një hadith tjetër, Pejgamberi (a.s) thotë për rëndësinë e Kur'anit: "Pas vdekjes sime do të ketë shumë prova". Dikush e pyeti: "Si të shpëtojme prej tyre"? Profeti (a.s) u përgjigj: "Keni libri e Zotit, aty ka lajme për ata që erdhën para jush. Aty ndodhet çështja e atyre që vijnë pas jush. Aty ndodhet gjykimi mes jush. Kur'ani e ndan drejtën nga e shtrembëta dhe aty nuk ka lajka. Kush e braktis atë libër nga frika e një diktatori, Zoti e shkatërron atë njeri. Kush kërkon udhëzimin jashtë tij, Zoti ka për ta humbur. Ai është litari i fortë i Zotit, është udhëzues i urtë dhe rruga e drejtë. Mrekullitë e tij nuk mbarohen. Dijetaret nuk kanë të ngopur prej tij dhe kush flet me të, ka thënë të vërtetën. Kush punon me të, shpërblehet. Kush gjykon me të, ka gjykuar drejt. Kush fton për tek ai, udhëzohet në rrugën e vërtetë".

Muaji i Ramazanit është muaji i Kur'anit, prandaj o vëlla i nderuar, shfrytëzoje këtë muaj me leximin e Kur'anit, ditën dhe natën. Ata që e lexojnë Kur'anin duke medituar në madhësinë e ajeteve të tij, shpërblehen me mëshirë, qetësi dhe falje gjynahesh.

Kur'ani nuk është thjesht një libër besimi, që mbush zemrat dhe shpirtat me dritë, por ai është ligji dhe programi i jetës së njeriut. Kur jobesimtarët dhe idhujtarët e Mekës me arrogancë dhe mendjemadhësi kërkuan një mrekulli nga Profeti (a.s), që të besonin, përgjigja Hyjnore ishte, se a nuk u mjaftonte atyre, që herë pas here u zbrisnin ajetet kuranore?

Besimtarët e vërtetë kur shpresojnë në mëshirën dhe bujarinë e Krijuesit, ata ndryshojnë nga të tjerët nga disa pikëpamje:

1-Kur lexojnë ajetet e mëshiruesit, bien në sexhde duke qarë, të përulur dhe duke shpresuar tek shpërblimi hyjnor.

2-Kur e dëgjojnë Kur'anin, kanë

respekt dhe sillen me edukatë ndaj Tij.

Disa prej të parëve tanë të mirë e lexonin të plotë Kur'anin (Hatme) çdo tre net, disa prej tyre çdo javë, e disa prej tyre çdo dhjetë ditë. Ku jemi ne sot për këtë begati që na ka dhënë Krijuesi i Gjithësisë dhe a jemi duke ndjekur hapat e të parëve tanë?

Imam Ahmedi na tregon. Një nxënës i tij e lexonte gjithë Kur'anin brenda një nate. Imam Ahmedi nuk i erdhi mirë kur e dëgjoji këtë, prandaj e thirri dhe i tha: Kam dëgjuar se ti e lexon Kur'anin brenda një nate, sonte do ta lexosh Kur'anin sikur je përpara meje". Djaloshi shkoj në shtëpi dhe filloi ta lexonte Kur'anin, sikur të ishte para mësuesit te tij. Ai arriti të lexonte vetëm një xhuz (1/30 e Kur'anit). Të nesërmen i tha mësuesit të tij, se kishte lexuar vetëm një xhuz, për shkak të turpit që kishte ndërjer sepe kishte imagjinuar se imami ishte prezent bashkë me të gjatë leximit.

Imami i tha: Sontë do ta lexosh Kur'anin sikur je përpara Profetit (a.s). këtë radhë djaloshi, duke menduar se ishte përpara Profetit (a.s), nuk arriti të lexonte më shumë se një sure.

Të nesërmen ia tregoi mësuesit të tij këtë gjë. Atëherë Imami i tha: Shko, dhe sonte lexoje Kur'anin sikur po e lexon përpara All-llahut (xh.sh), pasi është libri i Tij dhe Ai e ka zbritur. Të nesërmen nxënësi kthehet me sy të skuqur tek Imam Ahmedi dhe i thotë mësuesit të tij duke qarë: Pasha Zotin, o imam nuk arrita ta plotësoj një ajet sepe mendoja All-llahun (xh.sh) para meje. Sa shumë e paskam neglizhuar këtë libër!

Prandaj, o ymeti i Kur'anit, kthejuni atij, lexojeni, mësojeni përmendësh, punoni dhe gjykoni sipas tij.

E lus Krijuesin e Gjithësisë, që të na bëjë prej njerëzve që e lexojnë Kur'anin dhe veprojnë me të.

TERAVIA E PARË, FLUKS I MADH BESIMTARËSH

Thirrja e ezanit të akshamit të datës 26 maj 2017 lajmëroi ardhjen e muajit të begatë të Ramazanit për këtë vit, ndërsa salavati, që vinte nga minaretë e xhamisë së Parrucës i jepte dritë natës së parë të teravisë.

Fluksi i madh i besimtarëve në të gjitha xhamitë e Shkodrës në faljen e teravisë së parë, dëshmoi edhe një herë se shpirti i besimtarëve shkodranë është i lidhur fort me namazin dhe xhaminë.

Siç dihet, namazi i teravisë është traditë Profetike dhe falja e tij bëhem vetëm në muajin e begatë të Ramazanit. Ky namaz është falur dhe vazhdon të falet në mbarë botën isalme me njëzet rekatë namaz.

E lusim Allahu e Madhëruar të na e bëjë këtë muaj të shenjtë të Ramazanit, paqe, mirësi dhe begati për ne dhe për krejt besimtarët myslimanë shqiptarë dhe anekënd botës.

Agjërim të lehtë dhe të pranuar tek Allahu (xh.sh)!



IFTARI TRADICIONAL ME IMAMËT DHE KËSHILLIN E MYFTINISË SHKODËR

Ditën e dytë të Ramazanit, më 28 maj 2017, imamët dhe këshilli i Myftinisë Shkodër janë mbledhur në iftarin tradicional që shtrohet me rastin e Muajit të begatë të Ramazanit.

Në sofrën e begatë të vëllazërisë dhe harmonisë islame, imamët e qytetit dhe të fshatrave, ndanë me njëri-tjetrin përvojat dhe kënaqësitë e ditëve të para të këtij muaj plot mirësi dhe begati.

Teologu Arben Halluni, në emër të Myftinisë Shkodër, uroi mirëseardhjen të gjithë imamëve duke shprehur mirënjohje dhe respekt për punën e tyre fisnike në shërbim të Thirrjes Islame.

Ai theksoi se muaji i Ramazanit është një mundësi e madhe për të qenë çdo natë të teravisë pranë xhematit, sikurse duhet shfrytëzuar në maksimum për të mirën e njerëzve dhe të fesë.

Në fund të këtij iftari vëllazëror, teologu Lavdrim Hamja, falënderoi edhe një herë imamët e nderuar për angazhimin e tyre të përhershëm në shërbimet ndaj vlerave të besimit islam që përhapin çdo ditë.

Ky iftar u mbyll me duanë e rastit, të cilën e bëri Hafiz Shukri Kapllan.



Tradita e bukur e shtrimit të iftareve gjatë muajit të Ramazanit, tashmë ka marrë rrugëtimin e saj dhe për çdo

ditë të Ramazanit, iftaret do të jenë të pranishme në mesin e xhemateve dhe agjëruessve të ndryshëm.

TRADITA E LEXIMIT TË KUR'ANIT FAMËLARTË NË XHAMINË E PARRUCËS



Tashmë është bërë një traditë shumë e bukur, që me fillimin e muajit të begatë të Ramazanit, të fillohet edhe leximi i plotët i Kur'anit Famëlartë, ose siç quhet ndryshe Hatmeja Sherife. Kjo ka nisur që në vitet e para të rilejimit të fesë në Shqipëri dhe vazhdon akoma edhe sot, duke u shtuar numri i besimtarëve që marrin pjesë në këtë lexim të Kur'anit Famëlartë.

Për disa vite me radhë, leximi i Hatmes Sherife po bëhet në xhaminë e Parrucës, ku besimtarë të shumët, pasi falin me xhemat namazin e Iqindisë, në prani të hoxhallarëve të xhamive të qyteti, fillojnë e lexojnë Kur'anin Famëlartë.

Kjo traditë islame me vlerë e myslimanëve të Shkodrës, po bëhet gjithnjë e më e përhapur, pasi edhe në xhami të tjera të qytetit zhvillohen lexime të Kur'anit Famëlartë.

Leximi i plotë i Kur'anit Famëlartë gjatë muajit të madhërueshëm të Ramazanit është pasim i brezave të parë të mirë, të cilët me ardhjen e Ramazanit

i përkushtoheshin shumë leximit të Librit të Allahut (xh.sh).

Myftinia Shkodër fton të gjithë ata që kanë mundësi të marrin pjesë në këtë ndjenje të begatë, t'i bashkohen kësaj tradite të bukur dhe të marrin prej dritës së Kur'anit e të përfitojnë prej

sa më shumë nga leximi i tij, sidomos gjatë këtij muaji të begatë, muajit të Ramazanit.

Hatmeja Sherife lexohet çdo ditë pas namazit të Iqindisë, në xhaminë e Parrucës.

“RAMAZANI, MUAJI I DURIMIT DHE I PËRKUSHTIMIT”



Paraditën e sotme, më 1 qershor 2017, Myftinia Shkodër në bashkëpunim me Medresenë “Haxhi Sheh Shamia” organizuan në xhaminë e Medresesë, tribunën fetare me temë: “Ramazani, muaji i durimit dhe i përkushtimit”.

Hapjen e këtij aktiviteti e bëri teologu Arben Halluni, i cili në emër të Myftinisë Shkodër uroi nxënësit e Medresesë agjërim të mbarë dhe të pranuar tek Allahu (xh.sh). Ndër të tjera, ai tha se: Aktiviteti i sotëm është vazhdim i karvanit të aktiviteteve, të cilat Myftinia Shkodër ka filluar t'i organizojë që para fillimit të Ramazanit dhe do të vazhdojë me aktivitete të larmishme edhe gjatë këtij muaji të begatë. Qëllimi i këtyre aktiviteteve është sensibilizimi dhe përkujtimi i besimtarëve, në mënyrë që të përfitojnë sa më shumë prej mirësive dhe begatave të muajit të madhërueshëm të Ramazanti.

Aktivitetin e përshëndeti edhe z. Kujtimi Dervishi, drejtor i Medresesë, ku ndër të tjera theksoi rëndësinë që kanë aktivitetet me nxënësit, sidomos gjatë muajit të begatë të Ramazanit. Ai i uroi nxënësve mbarësi dhe suksese në mësim dhe maturantëve provime të mbara.

Pastaj tribuna fetare vazhdoi me ligjëratat e mbajtura nga Lavdrim

Hamja, imam i xhamisë së “Dy Vajzave”, i cili mbajti temën “Ramazani, muaji i përkushtimit”. Në temën e tij, imami u ndalë të qëllimi i agjërimit, që është përkushtimi dhe përmirësimi i gjendjes shpirtërore dhe morale të besimtarit. Ai theksoi, se ky muaj i begatë duhet të shfrytëzohet maksimalisht për adhurime dhe vepra të mira, në mënyrë që të arrihet përkushtimi, të cilin Zoti i Madhëruar e bërë shkak të agjërimit.

Ndërsa, Naim Drijaj, imam i xhamisë

së Parrucës mbajti temën “Ramazani, muaji i durimit”. Ai u ndalë te kjo cilësi e lartë, që nuk ka të krahasuar me të. Gjatë ligjëratës së tij, ai solli argumente dhe shembuj, të cilët bëjnë të qartë, se durimi është në virtyt i bukur dhe të cilin e do Allahu (xh.sh). Gjithashtu imami, tregoi se durimi ndahet në disa pjesë, si durimi në adhurim, durimi ndaj gjynahut, durimi në sprova etj.

Pas tribunës fetare, u bë edhe falja e namazit të drekës me xhemat.

AMBASADA E KUVAJTIT NË NDIHMË TË NJERËZVE NË NEVOJË



Ditën e shtunë, më 3 qershor 2017, në ditën e 8-të të muajit të madhëruar të Ramazanit përfaqësuesi i Myftinisë Shkodër, teologu Arben Halluni priti në një takim vëllazëror dhe miqësor z. Jaser Al-Bader, konsull në Ambasadën e Shtetit të Kuvajtit në Tiranë.

Gjatë takimit, përfaqësuesi i Myftinisë Shkodër falënderoi për zemërsisht ambasadën kuvajtiane, qeverinë dhe popullin mik e bujar të Kuvajtit për ndihmat dhe kontributet e gjithanshme që ka dhënë dhe jep prej vitësh për popullin shqiptar, sidomos gjatë muajit të bekuar të Ramazanit,

duke shpërndarë me mijëra pako me ndihma ushqimore nëpër qytete të ndryshme të vendit.

Nga ana e tij, z. Jaser Al-Bader shprehu kënaqësinë që gjendet në mesin e vëllezërve të tij në Shkodër për të uruar muajin e begatë të Ramazanit, por edhe për t'ju gjendur pranë me ndihma ushqimore familjeve në nevojë.

Ai theksoi se Shteti i Kuvajtit e ka në themel aktivitetin humanitar dhe përkrahjen e njerëzve në nevojë anembanë botës.

Me rastin e kësaj vizite, u bë edhe shpërndarja e ndihmave për agjërues dhe njerëz në nevojë.



"JEHONË RAMAZANI"



Myftinia Shkodër

JU FTON TË NDIQNI EMISIONIN:

"JEHONË RAMAZANI"

NË Radio JEHONA 107.6 FM ME

RUBRIKA SI:

KUR'AN, ME FJALËT E ALLAHUT,

RAMAZANI DHE BESIMTARËT,

PEJÇAMBERI (A.S) KA THËNË,

EZANI I AKSHAMIT (IFTARI),

NJOFTIMI PËR ORARIN

E SYFYRIT DHE IFTARIN

PËR DITËN E NESËRME,

dua-lutje, KARVANI

I RAMAZANIT, ILAHI ETJ...

Çdo dite pas orës: 19.05

- 21.15 dhe Emisioni:

"EL-FATIHA" çdo nate pas

orës: 11.45 - 07.00.

- NËN kujdesin

e Myftinisë Shkodër -



- HADITHE PËR MIRËSINË E RAMAZANIT -

Ebu Hurejra (r.a) transmeton se Pejgamberi (a.s) ka thënë:

Allahu (xh.sh) thotë: "Çdo punë e birit të Ademit është e tij, përveç agjërimit. Ai është i imi dhe Unë e shpërblej atë. Agjërimi është mburojë! E, kur të jetë agjërueshëm ndonjëri prej jush, të mos flasë fjalë jo të hijshme dhe të mos bërtasë. E, nëse dikush e shan ose e qodet, le të thotë: Unë jam agjërueshëm. Pasha atë që shpirti i Muhamedit është në dorën e Tij, era e gojës së agjëruesit është më e mirë tek Allahu se sa era e miskut. Për agjëruesin ka dy qezime: kur bën iftar qezohet për iftarin e tij, dhe kur të takojë Zotin, do të qezojë për agjërimin e tij."

- (Buhariu dhe Muslimi) -

Ebu Hurejra (r.a) tregon se Pejgamberi (a.s) ka thënë:

"Allahu i lartësuar jua ka bërë obligim agjërimit e Ramazanit, ndërsa unë jua kam bërë sunet (traditë) namazin e tij (teravinë). Kështu që, kush e agjëron Ramazanin dhe falë teravinë, me besim, me bindje dhe vendosmëri, ai njeri do të dalë nga Ramazani i pastër nga qabimet, si ditën që e ka lindur nëna e tij."

- (Nesaiu) -

Sehël ibn Sead (r.a) transmeton se Pejgamberi (a.s) ka thënë:

"Në xhenet është një derë, e cila quhet "Rejjan", përmes saj hyjnë agjëruesit në Ditën e Kiametit. Askush tjetër nuk hyn prej saj, përveç tyre. Thuhet: Ku janë agjëruesit? Ata ngrihen në këmbë, hyjnë nga ajo derë, pastaj ajo mbyllet."

- (Buhariu) -

- KËSHILLA RAMAZANI -

- **RUAJE ZEMRËN DHE NIJETIN!**
- **DHURO ÇDO DITË NJË SADEKA!**
- **PËRKUSHTOJA KOHËN KUR'ANIT! ÇDO DITË LEXO PREJ TIJ!**
- **DHURO BUZËQESHJE DHE PAJTO NË MESIN E NJERËZVE!**
- **THUJ PA NDROJTJE: "JAM AGJËRUESHËM!"**
- **KONTROLLO MARRËDHËNIEN ME NAMAZIN!**
- **RUAJE SHIKIMIN, KONTROLLOJI FJALËT, MOS LËNDO NJERI!**
- **BËJE IFTARIN MJET AFRIMI ME FAMILJEN, FAREFISIN, MIQËSINË!**
- **MOS U KURSE PËR TË DHËNË SADEKATUL-FITRIN, 200 LEKË PËR PERSON!**
- **ZEKATI ËSHTË SHTYLLË E RËNDËSISHME E FESË TËNDE, MOS E NEQLIZHO!**
- **NATA E KADRIT? LUTU DHE KËRKO FALJE, DYERT E MËSHIRËS JANË HAPUR!**

- AGJËRIM TË LEHTË DHE TË PRANUAR! -

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org